



Financuar nga
Bashkimi Evropian

SFIDAT E GRAVE DHE VAJZAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR PËRGJATË COVID-19 NË KOMUNËN E MITROVICËS



**HANDIKËS
MITROVICA**

Shoqata e Personave me Aftësi të
Kufizuar të Mitrovicës

RAPORTI I
HULUMTIMIT

**SFIDAT E GRAVE DHE VAJZAVE ME
AFTËSI TË KUFIZUAR PËRGJATË
COVID–19 NË KOMUNËN E MITROVICËS**

Gusht, 2022

© Shoqata e Personave me Aftësi të Kufizuar të Mitrovicës – Handikos Mitrovica, 2022

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Ky botim mund të kopjohet dhe të shpërndahet, për sa kohë që deklarohet burimi.

Drejtoreshë Ekzekutive: Myrvete Hasani

Autorë: Dea Stavileci

Ky hulumtim është hartuar me përkrahjen nga Fondi i Grave të Kosovës me mbështetjen e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë përmes nismës së Rrjetit të Grave të Kosovës "Ngritja e kapaciteteve dhe qëndrueshmërisë së OShC-ve: Avancimi i barazisë gjinore në mes të pandemisë COVID-19". Pikëpamjet e shprehura në raport nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë si donator i projektit.

FALËNDERIM

Shoqata e Personave me Aftësi të Kufizuar të Mitrovicës – Handikos Mitrovica falënderon të gjitha pjesëmarrësit në hulumtim, duke përfshirë gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuar, nënat e fëmijëve me aftësi të kufizuar si dhe ofruesit e shërbimeve në institucione publike që kanë ndarë përvojat e tyre. Ekipi hulumtues i Handikos Mitrovica, i përbërë nga Blinera Kajtazi dhe Leonita Sadiku punuan pareshtur për të realizuar dhe transkriptuar intervistat. Dea Stavileci mbështeti ekipin dhe bëri shkrimin e raportit. Edin Lahi realizoi takimet me institucionet, fokus grupet dhe ofroi këshilla për raportin. Bukuriye Brezhnica realizoi seancat psiko-terapeutike dhe ngriti gjendjen emocionale të grave dhe vajzave me aftësi të kufizuar. Autorja falënderon Drejtoren Ekzekutive të Handikos Mitrovica Myrvete Hasani, Zyrtarin e Administratës dhe Financave Erzen Isufi, Asistentin e Financave Shaban Hasani dhe Punëtoren Sociale të qendrës Blinera Kajtazi për angazhimin vullnetar dhe përkrahjen e tyre të vazhdueshme.

Ky publikim u rishikua nga Rita Berisha, Donjeta Berisha dhe Nicole Famsworth, përfaqësuese të Rrjetit të Grave të Kosovës (RrGK). Handikos Mitrovica veçanërisht falënderon RrGK-në për besimin dhe mbështetjen gjatë realizimit të këtij hulumtimi. Raporti është financuar nga Zyra e BE-së në Kosovë me një kontribut të konsiderueshëm pa pagesë nga stafi i Handikos Mitrovica.

PËRMBAJTJA

SHKURTESAT	3
PËR HANDIKOS MITROVICA.....	4
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	5
HYRJE.....	7
METODOLOGJIA E HULUMTIMIT	9
KORNIZA LIGJORE.....	11
Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDPAK).....	11
Korniza Ligjore e Kosovës	12
TË GJETURAT	15
Gjendja psiko-emocionale përgjatë COVID-19.....	15
Shëndetësia	18
Shërbimet sociale.....	22
Punësimi.....	24
Arsimi.....	26
MONITORIMI I MASËS 1.6 TË PAKOS SË RINGJALLJES EKONOMIKE.....	30
KONKLuzionET DHE REKOMANDIMET.....	33
Buxhetimi lokal financiar.....	33
Shëndetësia	34
Shërbimet sociale.....	35
Arsimi.....	36
Punësimi dhe zbatimi i masës 1.6 të PRE.....	36
BURIMET E CITUARA	38
SHTOJCA 1. PyetëSORI.....	40

SHKURTESAT

AK	Aftësi e Kufizuar
BE	Bashkimi Evropian
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
KDPAK	Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara
KPSH	Kujdesi Parësor Shëndetësor
FAK	Fëmijë me Aftësi të Kufizuar
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OJQ	Organizatë jo-qeveritare
OSHC	Organizatë e Shoqërisë Civile
OPAK	Organizatat e Personave me Aftësi të Kufizuar
LVL	Ligji për Vetëqeverisje Lokale
PAK	Person me Aftësi të Kufizuar
PRE	Pakoja e Ringjalljes Ekonomike
QKMF	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
QMF	Qendra e Mjekësisë Familjare
QPS	Qendra për Punë Sociale
RrGK	Rrjeti i Grave të Kosovës
DIEMS	Drejtoria e Integriteteve Evropiane dhe Mirëqenies Sociale

PËR HANDIKOS MITROVICA

Handikos Mitrovica është një shoqatë që vepron për personat me aftësi të kufizuara në komunën e Mitrovicës dhe është prezente me aktivitete konkrete që para periudhës së luftës. Kjo organizatë numëron rreth 550 anëtarë vetëm në Mitrovicë dhe synon t'iu jap atyre shërbime sa më cilësore.

Nga viti 2000 deri më 2015, Handikos Mitrovica ka funksionuar si Qendër e Rehabilitimit Bazuar në Bashkësi si rrjet i HANDIKOS, ku më pas në vitin 2015 pas decentralizimit të HANDIKOS, Handikos Mitrovica është regjistruar si entitet në vete duke vepruar si një organizatë jo-qeveritare dhe është përkrahësi kryesor i personave me aftësi të kufizuara në rajonin e Mitrovicës. Kjo organizatë punon në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe pavarësimin e personave me aftësi të kufizuara fizike përmes shërbimeve, vetëdijësimit dhe avokimit.

Vizioni i Handikos Mitrovica është që të krijojë një shoqëri gjithëpërfshirëse me njohje dhe respektim të plotë të të drejtave dhe mundësive të barabarta të personave me aftësi të kufizuara fizike.

Handikos Mitrovica ofron shërbime të drejtpërdrejta sociale për personat me aftësi të kufizuara në rajonin e Mitrovicës, duke zbatuar një Program Rehabilitimi Bazuar në Komunitet, siç janë.

- Ofrimi i shërbimeve të kujdesit ditor për fëmijët me aftësi të kufizuara, bazuar në standardet e shërbimit dhe me staf të kualifikuar profesional;
- Ngritja e kapaciteteve të prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara në aspektin e kontributit në zhvillimin e fëmijëve të tyre në potencialin e tyre të plotë, si dhe këshillim individual dhe grupor me prindërit/anëtarët e familjes;
- Avokim aktiv në institucionet vendore publike dhe jopublike, për të garantuar mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në shoqëri, duke përfshirë të drejtën për lëvizje të lirë, shërbime shëndetësore cilësore, mirëqenie sociale, arsim dhe punësim;
- Shërbimet e pajisjeve ndihmëse për fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara në qendër dhe në shtëpi, duke iu përshtatur nevojave të përfituesit;
- Identifikimi i vazhdueshëm i fëmijëve dhe të rriturve me aftësi të kufizuara dhe regjistrimi i tyre në bazën e të dhënave;
- Ofrimi i shërbimeve sociale dhe ngritja e kapaciteteve të rriturve me aftësi të kufizuar, si dhe këshillime individuale dhe grupore;
- Këshillim dhe këshillim për aftësitë e përditshme të jetesës dhe lëvizshmërinë.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në këtë raport shqyrtohen sfidat e grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara përgjatë COVID-19 në komunën e Mitrovicës. Ky hulumtim është hartuar me përkrahjen nga Fondi i Grave të Kosovës me mbështetjen e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë përmes nismës së Rrjetit të Grave të Kosovës "Ngritja e kapaciteteve dhe qëndrueshmërisë së OShC-ve: Avancimi i barazisë gjinore në mes të pandemisë COVID-19". Ky hulumtim ka pasur për qëllim dokumentimin e përvojave të grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara përgjatë pandemisë COVID-19, dhe avokimin për zbatimin e të drejtave të tyre. I realizuar në vitin 2022, hulumtimi ka përdorur metoda të kombinuara: shqyrtimin dokumentar, intervistat direkte, vëzhgimin e pjesëmarrësve dhe fokus grupet.

Një hulumtim bazë gjithëpërfshirës është realizuar përmes të cilit u identifikuan nevojat dhe problemet e grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara ku u përfshin këto objektiva: Dokumentimi i përvojave të grave dhe vajzave me AK përgjatë pandemisë COVID-19, dhe avokimi për zbatimin e të drejtave të tyre; Ngritja e mirëqenies sociale për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara përmes ofrimit të shërbimeve direkte psiko-terapeutike; dhe Vetëdijësimi i institucioneve relevante dhe qytetarëve të Mitrovicës për të drejtat e grave dhe vajzave me AK.

Gratë në shoqërinë Kosovare janë ende subjekt i diskriminimit dhe pabarazisë, në këto rrethana, të qenit grua me aftësi të kufizuara e përkeqëson më tej situatën. Gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara përfaqësojnë një nga grupet më të marginalizuara të shoqërisë në të cilën jetojmë dhe që i nënshtrohen diskriminimit të shumëfishtë. Korniza ligjore e Kosovës sa i përket sferës së aftësisë së kufizuara duket disi gjithëpërfshirëse, mirëpo edhe zbatimi i atyre ligjeve ekzistuese në praktikë është shumë i dobët. Deri më tani, këto politika kanë dështuar të trajtojnë apo ofrojnë zgjidhje për eliminimin e diskriminimit të përjetuar në përditshmëri. E tillë është situata për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara në Kosovë.

Ndër të tjera, nga sfidat kryesore të cilat kanë ekzistuar për një kohë të gjatë para pandemisë për personat me aftësi të kufizuara, i referohen stereotipeve dhe paragjyqimeve të cilat janë gjithnjë e më të pranishme në shoqërinë tonë, infrastruktura që nuk është e qasshme, praktikat diskriminuese në sistemin arsimor dhe në tregun e punës, por edhe institucionet që nuk janë llogaridhënëse. Sfidat e grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara në qasje në shërbime cilësore sociale dhe shëndetësore, arsim dhe punësim janë të pashterura. Supozohet të kenë të drejta të barabarta si pjesa tjetër e popullsisë, por përkundrazi gratë me AK përballen çdo ditë me diskriminim, teksa përpiqen të kapërcejnë stigmën, paragjykimin dhe barrierat e shumta me të cilat përballen, duke filluar nga familjet e tyre dhe mjedisi

që i rrethon, dhe kalimi në shoqërinë që i ka harruar ato; gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara përpiqen të sigurojnë për vete qasjen në shërbime në ato raste kur qeveria nacionale e lokale nuk i ndihmon.

Ky raport përmban rekomandime për akterë të ndryshëm për avancimin e shërbimeve për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuar.

HYRJE

Në mars të vitit 2020, Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) ka shpallur pandeminë për shkak të koronavirusit të ri¹, disa muaj pasi virusi është paraqitur në Republikën Popullore të Kinës dhe është zgjeruar në pjesët tjera të botës².

Në fillim të pandemisë, OBSH ka paralajmëruar se ekziston rrezik i madh nga infektimi me virusin tek personat me aftësi të kufizuara. Kjo është si rrjedhojë e pengesave ekzistuese për zbatimin e masave themelore për mirëmbajtjen e higjienës, vështirësitë për mirëmbajtjen e distancës për shkak të nevojës për mbështetje shtesë, nevoja për prekje si mënyrë për pranimin e informatave nga mjedisi jetësor dhe probleme të mëparshme shëndetësore.³ Situata në të cilën janë sjellur personat me aftësi të kufizuara si rezultat i drejtëpërdrejtë i pandemisë është vetëm tregues i dobësive ekzistuese të sistemit të shërbimeve publike dhe qasjes jo të barabartë për kategoritë e caktuara të rrezikuara.⁴

Edhe pse pandemia COVID-19 ka prekur të gjithë, masat për trajtimin dhe pasojat e shkaktuara në mënyrë të ndryshme dhe jo të barabartë janë pasqyruar në kategoritë e ndryshme të qytetarëve. Kështu, pandemia me virusin korona vetëm ka intensifikuar dhe ka shfaqur problemet me të cilat përballen në përditshmëri personat me aftësi të kufizuara, prindërit e tyre dhe personat që kujdesen për ta. Treguesit për pengesat në funksionimin e përditshëm të personave me aftësi të kufizuara para pandemisë janë edhe të dhënat se ata janë ndërmjet grupeve të qytetarëve të drejtat e të cilëve më së shpeshti shkelën dhe përballen me diskriminim.

Sfidat e përmendura për personat me aftësi të kufizuara janë theksuar në mënyrë të konsideruar nga trajtimi jo adekuat me pandeminë e shkaktuar nga COVID-19. Mosinformimi mbi sëmundjen e COVID-19, mbyllja e qendrave, mësimdhënia jo e përshtatur në distancë dhe pamundësia që të sigurohet masa për distancën e nevojshme të personat që varen nga mjetet ndihmëse për funksionimin e

¹ Organizata Botërore e Shëndetësisë (2020, mars). *WHO Director-General's opening remarks at the media briefing on COVID-19 - 11 March 2020*: <https://www.who.int/dg/speeches/detail/who-director-general-s-opening-remarks-at-the-media-briefing-on-covid-19---11-march-2020>.

² Organizata Botërore e Shëndetësisë (2020). *Timeline: WHO's COVID-19 response*. [Timeline of WHO's response to COVID-19](#)

³ Organizata Botërore e Shëndetësisë (16 mars, 2020). *Disability considerations during the COVID-19 outbreak*. [Disability considerations during the COVID-19 outbreak \(who.int\)](#)

⁴ Organizata e Kombeve të Bashkuara (23 prill, 2020). *COVID-19 and Human Rights - We are all in this together*. [UNSDG | COVID-19 and Human Rights: We are all in this together](#)

pandërprerë janë vetëm disa nga problemet që kanë prekur përditshmërinë e personave me aftësi të kufizuara.

Duke pasur parasysh atë që në përdorim më të gjerë ka më shumë nocione për këtë problematikë, për qëllimet e këtij raporti e përdorim nocionin “gra dhe vajza me aftësi të kufizuara”, ku nocioni “aftësi të kufizuara” ka të bëjë me marginalizimin e grupit të njerëzve në shoqërinë për shkak të qëndrimeve sociale dhe kulturore, si dhe barrierave fizike në mjedisin. Sfidat dhe rreziqet me të cilat ballafaqohen gratë me aftësi të kufizuara janë pasojë e drejtpërdrejtë e stigmatizimit në shoqëri, gjë që krijon barrë të dyfishtë të diskriminimit mbi këto gra.

Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar rezolutën që viti 2022 të shpallet vit i personave me aftësi të kufizuara. Me shpalljen e vitit 2022, Ministrinë, Organizatat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe shoqëria në përgjithësi synojnë të mobilizojnë resurset e tyre për të trasuar rrugën për një Kosovë pa pengesa dhe për të fuqizuar personat me aftësi të kufizuara, në mënyrë që ata të mund të gëzojnë të drejta të barabarta dhe të marrin pjesë plotësisht në të gjitha sferat e shoqërisë.

Qëllimi i hulumtimit është që të nxjerrë në pah sfidat me të cilat ballafaqohen gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, në fushën e shërbimeve shëndetësore, sociale, arsimit, tregut të punës, përfshirjes shoqërore dhe të drejtave të njeriut, duke dhënë rekomandime konkrete për tejkalimin e atyre problemeve, pengesave dhe barrierave. Hulumtimi kontribuon për një analizë gjithëpërfshirëse dhe sistematike të përgatitur përmes analizimit të të dhënave nga dokumentet zyrtare, literaturës ekzistuese dhe të dhënat e fituara nga intervistat dhe fokus grupet me gratë dhe vajzat me AK.

Në fokusin e këtij hulumtimi është ndikimi i pandemisë mbi jetën e përditshme të grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara, në përgjithësi, si dhe ndikimi i politikave të miratuara që i referohen qasjes të tyre në të drejta dhe shërbime. Më konkretisht, në pjesën e parë, hulumtimi analizon rregullativën pozitive ligjore dhe standardeve ndërkombëtare që kanë të bëjnë me të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Pjesa e dytë analizon përgjigjet e të anketuarve, të nevojshme për shqyrtimin e ndikimit të pandemisë mbi personat me aftësi të kufizuara dhe sfidave që kanë hasur. Në pjesën e tretë përmbahen përvojat personale të drejtëpërdrejtë të grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara dhe personat që kujdesen për to në raport me pasojat e përjetuara nga pandemia dhe masat jo të denja për trajtimin e saj. Përfundimisht, në fund kemi përfundimet dhe rekomandimet për zbutjen e efekteve negative nga pandemia COVID-19 mbi personat me aftësi të kufizuara, si dhe miratimin e politikave që do të marrin parasysh rrethanat e tyre specifike.

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Hulumtimi ka përfshirë metoda të ndryshme, duke përfshirë një desk-analizë e dokumenteve, politikave dhe ligjeve në sferën e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara; 50 intervista ballë për ballë me gra dhe vajza me aftësi të kufizuara; katër (4) grupe fokusi me gra dhe vajza me AK; realizimi i takimeve me tetë (8) institucione përkatëse në komunën e Mitrovicës dhe vëzhgimin e pjesëmarrëseve. Në hulumtim kanë marrë pjesë 20 vajza (mosha 15–29), 42 gra (mosha 30+) dhe tre (3) burra, duke arritur në gjithsej 65 pjesëmarrës në hulumtim.

Fillimisht, përmes një analize ligjore, u shqyrtua dhe u vlerësua legjislacioni aktual për të drejtat e grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara. Gjatë analizës, u shqyrtuan ligjet ndërkombëtare, Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe ligjet përkatëse kombëtare të Kosovës. Përmes analizës ligjore u identifikuan edhe institucionet përkatëse, rolet dhe përgjegjësitë e tyre.

Së dyti, për zhvillimin e intervistave ballë për ballë me gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuar janë përfshirë gjithsej 50 të anketuar, prej të cilëve 36 ishin gra dhe vajza me aftësi të kufizuara, kurse 14 ishin persona që kujdesen për gratë me aftësi të kufizuara. Sipas vendbanimit, 26 nga të anketuarat jetojnë në Mitrovicë, ndërsa 24 nga to kanë vendbanime rurale. U intervistuan gra dhe vajza të ndryshme me aftësi të kufizuar të moshave të ndryshme të etnisë shqiptare. Sipas llojit të aftësisë të kufizuar, pjesa më e madhe e të anketuarave kanë theksuar se kanë aftësi të kufizuara fizike (77,6 %). 14,3% kanë aftësi të kufizuara intelektuale, kurse 4,1 % kanë aftësi të kufizuara sensorike (persona me shikim të dëmtuar dhe persona me dëgjim të dëmtuar). Dy anëtare të ekipit hulumtues zhvilluan secilën intervistë, ku njëra hulumtuese udhëhiqte intervistën ndërsa tjetra mbante shënime. Intervistat u regjistruan me pëlqimin gojor të të intervistuarve.

Së treti, hulumtuesit organizuan katër (4) grupe fokusi me 32 gra dhe vajza me AK. Grupet e fokusit u përpoqën të kuptonin më mirë pikëpamjet e grave dhe vajzave me AK, dhe nënave të fëmijëve me AK. Fokus grupi i I-rë është realizuar me gra me aftësi të kufizuara të cilat janë ofruese të shërbimeve në komunën e Mitrovicës. Qëllimi i këtij fokus grupi ishte që të eksplorojë përvojat e grave me aftësi të kufizuara të cilat janë të punësuar, duke synuar të identifikohen sfidat por edhe disa nga pikat e forta që ato mund t'i kenë pasur përgjatë procesit të punësimit. Qëllimi i fokus grupit të II-të ishte që të eksplorojë përvojat e nënave të fëmijëve me AK rreth sfidave të tyre dhe të rritjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara. Qëllimi i fokus grupit të III-të ishte të zbuloj sfidat e vajzave dhe grave me aftësi të kufizuara duke i dëgjuar përvojat e tyre personale, duke u përpjekur të bëhen krahasime mes

të dhënave të kaluara dhe mes gjeneratave. Qëllimi fokus grupit të IV-të ishte trajtimi i çështjeve që lidhen me sfidat dhe vështirësitë e grave me aftësi të kufizuara dhe të prindërve të tyre duke u fokusuar në aspektin e qasjes dhe mungesës së saj. Në fillim të secilës intervistë dhe fokus grupi, pjesëmarrëset janë informuar se do të garantohet konfidencialiteti i informatave, dhënave, dhe deklaratave të tyre. Për shkak të mbrojtjes së të dhënave, në këtë raport nuk janë vendosur të dhënat personale, ndërsa citimet dhe shembujt nuk identifikojnë të anketuarat.

Së katërti, ekipi ka vizituar tetë (8) institucione për të diskutuar rreth të gjeturave nga ky hulumtim. Këto takime u zhvilluan me qëllim të adresimit të problemeve rreth Aftësisë së Kufizuar në komunën e Mitrovicës, si dhe përmes tyre u përpoqëm të kuptonim më mirë edhe pikëpamjet e zyrtarëve mbi ofrimin e shërbimeve ndaj grave me AK.

Ekipi hulumtues i Handikos Mitrovica i kodoi të dhënat cilësore që dolën nga intervistat sipas pyetjeve kërkimore. Në kodimin e secilës intervistë morën pjesë të paktën dy persona. Gjithashtu, është bërë analiza statistikore të të dhënave të anketimit duke përdorur softuerin SPSS. Për të maksimizuar përdorimin e të dhënave të mbledhura, të dhënat nga cilido që kishte plotësuar një pyetje të caktuar u përpunuan dhe u prezantuan. Sikurse të hulumtimi i bazuar, nën-seksionet në kuadër të kapitujve përqendrohen në temat dhe dimensionet kryesore që dolën nga hulumtimi.

Lidhur me kufizimet e hulumtimit, ky raport u përqendrua tek gratë, rolet, kontributet dhe nevojat e tyre, prandaj ekipi kryesisht bisedoi me gratë me AK në komunën e Mitrovicës. Si rrjedhojë, ky hulumtim paraqet pikëpamjet e grave dhe vajzave vetëm në komunën e Mitrovicës, dhe jo domosdoshmërisht të gjeturat pasqyrojnë përvojat e grave me aftësi të kufizuar edhe në komunat tjera të Kosovës.

Së dyti, duke marrë parasysh koston e realizimit të anketimit të një mostre më gjithëpërfshirëse, është përfshirë një numër i limituar i grave dhe vajzave me AK në Mitrovicë.

Së treti, meqë bëhet fjalë për një hulumtim të parë të këtij lloji për këtë tematikë, ka mungesë të literaturës relevante nacionale e lokale për aftësinë e kufizuar e cila mund të shërbejë si bazë dhe referencë në hulumtim.

KORNIZA LIGJORE

Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDKPAK)

Konventa e OKB për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara (KDKPAK) me Protokollin Fakultativ të saj është akti i parë i detyrueshëm juridik dhe instrumenti themelor ndërkombëtar në lidhje me të drejtat e personave me aftësi të kufizuara⁵. Qëllimi i KDKPAK "është të promovojë, mbrojë dhe të sigurojë gëzimin e plotë dhe të barabartë të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore nga të gjithë personat me aftësi të kufizuar, dhe të promovojë respekt për dinjitetin e tyre". KDKPAK karakterizohet nga një shprehje frymëzuese, e cila është kthyer në moto ndërkombëtare: "Asgjë për ne, pa ne". Duhet përmendur, që kjo konventë dhe nene të veçanta të saj, janë një përgjigje ndaj neglizhencës shumë të gjatë të legjislacionit ndërkombëtar lidhur me çështjen e diskriminimit të grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara.⁶

KDKPAK në nenin 6 thotë se "gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara janë pre e diskriminimeve të shumëfishta" dhe urdhëron që vendet nënshkruese duhet të "ndërmarrin masa për të siguruar plotësimin e plotë dhe të barabartë të të drejtave njerëzore dhe lirive themelore".⁷ Neni 6 është një dispozitë detyruese për mosdiskriminimin dhe barazinë që pa mëdyshje e nxjerr jashtë ligjit diskriminimin ndaj grave me aftësi të kufizuara dhe promovon barazinë e mundësive dhe atë të rezultateve.

Perspektiva gjinore dhe mospërshtatja interseksionale janë një përpunim shtesë nga ana e Komitetit për të drejtat e personave në Komentin e përgjithshëm nr.3 (2016) për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara. Komiteti jo vetëm që thekson se "gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara ka më shumë mundësi që të jenë të diskriminuara se sa burrat dhe djemtë me aftësi të kufizuara dhe gratë dhe vajzat që nuk kanë aftësi të kufizuara", gjithashtu shpreh brengosjen për "mungesën e inkuadrimin të perspektivës gjinore në politikat për aftësitë e kufizuara" dhe "mungesën e

⁵ Popovska, zh. (2018) Interpretues i Konventës ndërkombëtare për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Polio plus – Shkup, fq. 14

⁶ Konventa për Rehabilitimin Profesional dhe Punësimin (Personat me aftësi të kufizuara) Konventa, 1983 (Nr. 159), ILO është e para dhe e vetmja që adreson barazinë gjinore, barazinë mes burrave dhe grave të punësuar me aftësi të kufizuara. Koment i përgjithshëm mbi nenin 6 të KDKPAK, përgatitur nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të kufizuara 22.15.2015

⁷ KDKPAK neni 6 (a).

perspektivës për të drejtat e aftësive të kufizuara në politikat që e promovojnë barazinë gjinore”.⁸

Konventa parasheh detyrimin e shteteve që të ndërmarrin të gjithë masat e nevojshme (në pajtim me detyrimet tjera ndërkombëtare–juridike) për mbrojtjen dhe sigurinë e personave me aftësi të kufizuara në situata të rrezikut, duke përfshirë edhe situatat e jashtëzakonshme.⁹ Ky nen ndërlidhet me obligimin më të rëndësishëm që e jep Konventa në situata të krizës të këtyre përmasave, të shkaktuara drejtëpërdrejtë nga pandemia COVID-19. Gjithashtu, Konventa parasheh detyrimin themelor të shteteve nënshkruese gjatë zhvillimit dhe zbatimit të legjislacionit dhe politikave, si dhe proceset tjera të marrjes të vendimeve të cilat i referohen personave me aftësi të kufizuara, drejtëpërdrejtë të konsultohen me personat me aftësi të kufizuara dhe në mënyrë aktive t’i përfshijnë, duke përfshirë edhe fëmijët me aftësi të kufizuara përmes organizatave të cilat i përfaqësojnë.¹⁰

Korniza Ligjore e Kosovës

Kosova i nënshtrohet konventave ndërkombëtare dhe deklaratave për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, përfshirë Deklaratën Universale për Drejtat e Njeriut dhe “Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. Në linjë me “Konventën e OKB–së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara” në vitin 2013 në Kosovë është hartuar “Strategjia Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2013/23”.¹²

Hulumtimi “Standardet ndërkombëtare mbi çështjet e aftësisë së kufizuara: Ku qëndron Kosova?”, ka pasur për qëllim vlerësimin e zbrazëtirave të legjislacionit në fuqi në Kosovë në raport me Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, Acquis Communautaire të Bashkimit Evropian, Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm, Strategjisë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Planit Nacional të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara. Fatkeqësisht, rezultatet e hulumtimit pasqyrojnë se vetëm 30% e standardeve të kërkuara ndërkombëtare janë të integruara në ligjet në fuqi që rregullojnë çështjet e personave me aftësi të kufizuara. Raporti i hulumtimit ka identifikuar se një nga kategoritë themelore e të drejtave të tyre– Qasshmëria, ku

⁸ Koment i përgjithshëm nr.3 (2016) për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, Komiteti për të Drejtat e Personave me aftësi të kufizuara. [1620871\(un.org\)](https://www.un.org/development/dpd/publications/2016/03/1620871)

⁹ KDPAK neni 11

¹⁰ KDPAK neni 4 paragrafi 3.

¹¹ Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, 1948, [Universal Declaration of Human Rights | United Nations](https://www.un.org/development/dpd/publications/2016/03/1620871)

¹²Strategjia Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2013/23. http://handi-kos.org/wp-content/uploads/2004/03/strategjia_nacionale_finale_per_shtyp_3_gjuhet_bardh_e_zi_88013-2.pdf

vetëm 6,7%, të standardeve ndërkombëtare janë të përfshira në legjislacionin e Kosovës.¹³

Personat me aftësi të kufizuar janë subjekt i diskriminimit dhe mungesës së kujdesit institucional, duke filluar nga mungesa e kujdesit të duhur mjekësor dhe mungesa e infrastrukturës fizike. Qasje e kufizuar në ndërtesat publike, shkollat, objektet mjekësore dhe transporti mbetet problem, pavarësisht ekzistencës së udhëzimeve administrative përkatëse¹⁴.

Sipas organizatës Botërore të Shëndetësisë, PAK kanë qasje të limituar në shërbime shëndetësore dhe si rrjedhojë kanë nevoja të paplotësuara për kujdesin shëndetësor¹⁵.

Korniza ligjore e Kosovës nuk përfshin një përkufizim të qartë të aftësisë së kufizuar në përputhje me KDKPAK-në e OKB-së. Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për aftësimin, rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara e përkufizon aftësinë e kufizuar si një "kufizim në qasjen dhe aktivitetet e zakonshme në jetën e përditshme të një personi si rezultat i dëmtimeve fizike, shqisore, intelektuale ose mendore. parandaloni që ai/ajo të marrë pjesë në aktivitetet e jetës së përditshme".

Ligji 03/L-019 për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara i obligon institucionet publike dhe private që të punësojnë një PAK për çdo 50 të punësuar.¹⁶ Mbetet mjaft e paqartë se si është bërë kalkulimi i proporcionit 1 me 50 duke marrë parasysh që statistikën për personat me aftësi të kufizuar janë të mangëta. Edhe pse korniza ligjore vlerësohet të ketë disa dispozita plotësuese për integrimin e personave me aftësi të kufizuar në tregun e punës, megjithatë, sikurse me shumë ligje në Kosovë, situata në praktikë lë për të dëshiruar. Përfshirja e grave në punësim dhe procese vendimmarrëse, si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat, mbetet një sfidë kryesore. Pabarazia e rrënjosur thellë gjinore krahas diskriminimit për shkak të aftësisë së kufizuar i pengon gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara të kontribuojnë dhe të ndikojnë në programet e zhvillimit.

Në ndër objektivat e Strategjisë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2013/23 është edhe mbrojtja sociale që duhet të mbështet të gjithë personat në nevojë duke përmirësuar cilësinë e jetës së tyre. Kjo e drejtë dhe nevojë

¹³ HANDIKOS. Standardet ndërkombëtare mbi çështjet e aftësisë së kufizuar: Ku qëndron Kosova?. Mars 2020 http://handi-kos.org/wp-content/uploads/2004/05/Report_SHQ-29_04_20_95548.pdf

¹⁴ Komision Evropian. Raporti i Kosovës 2021

¹⁵ Disability and Health, Janar, 2018. World Health Organization (WHO)

¹⁶ Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara. <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2620>

është më e theksuar tek gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuar, si kategori e cila konsiderohet ndër më e rrezikuara në shoqëri. Instrument tjetër i rëndësishëm në aspektin e rregullimit ligjor të çështjes së përfitimit të pensione të financuara nga shteti për personat me aftësi të kufizuar është Ligji nr. 04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti¹⁷, i cili përfshin Skemën e Pensionit Bazik të Moshës, Skemën e Pensionit Kontribut pagues të Moshës, Skemën e Pensionit të Aftësisë së Kufizuar, Skemën e Pensionit të Parakohshëm, si dhe rregullon çështjet e pensionit familjar dhe invalidor të punës, në rastet kur kontribuuesit lëndohen në punë apo fitojnë sëmundje profesionale.

Mandati për ofrimin e shërbimeve sociale nga ana e komunave specifikohet në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale (LVL), Neni 17 nga lista e shërbimeve nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale për kompetencat vetanake të komunave, përfshin edhe ofrimin e shërbimeve familjare dhe shërbimeve të tjera të mirëqenies sociale, siç është përkujdesi për të cenueshmit, strehimi familjar, përkujdesi për fëmijën, përkujdesi për të moshuarit, regjistrimi dhe licencimi i qendrave përkujdesëse, punësimi, pagesa e rrogave dhe trajnimi i profesionistëve të mirëqenies sociale.¹⁸

Korniza legjislative mandaton Qendrat për Punë Sociale si organet kryesore të autoriteteve komunale për të siguruar ofrimin e kujdesit social, mbrojtjen sociale dhe këshillimin në rrethanat ku një fëmijë/i rritur ka nevojë për shërbime sociale dhe familjare. Referencat për kompetencat e Qendrave për Punë Sociale gjenden në disa ligje, duke përfshirë Ligjin për Shërbimet Sociale dhe Familjare¹⁹, Ligjin për Mbrojtje nga Dhuna në Familje²⁰ dhe Kodin e Drejtësisë për të Mitur²¹.

Është mendim i përgjithshëm se decentralizimi nuk u zbatua me sukses. Kjo ndoshta si pasojë e një keqkuptimi në komunikim, jo vetëm në aspektin e shpërndarjes së informacionit, por edhe mungesën e konsultimit dhe diskutimit mes palëve. Edhe në komunën e Mitrovicës, si në shumë komuna të Kosovës, ende mendojnë se shumë përgjegjësi i takojnë Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve edhe pse shihet qartë se shumica e komponentëve janë në duar të komunave.

¹⁷ Ligji nr. 04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=9517>

¹⁸ Ligji për Vetëqeverisjen Lokale NR. 03/L-040 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530>

¹⁹ Ligji Nr.02/L-17 për shërbime sociale dhe familjare. 2007 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2447>

²⁰ Ligji nr. 03/L-182 për mbrojtje nga dhuna në familje. 2010 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2691>

²¹ Kodi nr. 06/l-006 i drejtësisë për të mitur. 2018 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18019>


TË GJETURAT

Gjendja psiko-emocionale përgjatë COVID-19

Kjo pjesë i përgjigjet pyetjes se me çfarë sfidash janë përballur gratë dhe vajzat me AK në balancimin e jetës së tyre përgjatë COVID-19? Është e rëndësishme të kuptohet se në çfarë lloj formash ka ndikuar kjo krizë tek gratë dhe vajzat me AK, veçanërisht tek përjetimet e tyre përgjatë kësaj kohe, vështirësitë në marrjen e informacioneve dhe atyre financiare.

Kriza pandemike ka ndërprerë shumë aspekte të jetës të përditshme, por ndikimet e saja janë veçanërisht të theksuara për personat me aftësi të kufizuara. Personat me AK janë më të predispozuar për të përjetuar probleme të shëndetit mendor si depresioni dhe ankthi, të cilat jo gjithmonë mund të vërehen nga familjarët, për shkak se mund të shfaqen edhe si ankesa fizike (si kokëdhimbje apo dhimbje barku) apo kognitive (si vështirësi në përqendrim).²²


85% e të anketuarave janë shprehur që pandemia COVID-19 ka ndikuar në jetën e tyre të përditshme. Ndërsa, 15% e grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara kanë shprehur që kanë qenë të izoluar në shtëpi edhe para pandemisë si rrjedhojë e pamundësisë të lëvizjes.



Më poshtë janë paraqitur disa nga sfidat me të cilat janë përballur gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, dhe personat që kujdesen për personat me aftësi të kufizuara në balancimin e jetës së tyre gjatë pandemisë COVID-19.

²² Organizata Botërore e Shëndetësisë (16 mars, 2020). Disability considerations during the COVID-19 outbreak. [Disability considerations during the COVID-19 outbreak \(who.int\)](https://www.who.int/news-room/fact-sheets/detail/disability-considerations-during-the-covid-19-outbreak)

SFIDAT NË BALANCIMIN E JETËS GJATË PANDEMISË COVID-19




Konstatimet e hulumtimit treguan se dhuna është e pranishme në jetët e grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara. Një pjesë e konsiderueshme e kryerësve të dhunës dhe keqtrajtimit janë në familje. Përvojat e tilla fillojnë me ofendime dhe nënçmime, e arrijnë deri tek sulmet fizike dhe gjuajtjes me gjësende. Më shumë se gjysma e të anketuarave (59%) kanë përjetuar dhunë psikologjike në shtëpi, ndërsa 15% kanë përjetuar edhe atë fizike. Për vajzat me aftësi të kufizuara, nëna është ajo që më së shpeshti e ka rolin më të rëndësishëm për përkrahje në familje. Pyetjes se kujt do t'i tregonin së pari nëse do të përjetonin ndonjë lloj të dhunës, pothuajse gjysma e të anketuarave u përgjigjen se është nëna e tyre. Një pjesë e konsiderueshme (37%) thanë se nuk do t'i tregonin askujt sepse nuk kanë asnjë të afërm të familjes apo nuk kanë përkrahje nga prindërit (njëra prej tyre i citoi edhe fjalët e babait gjatë periudhës së izolimit: "Largoje qikën prej këtu, mshale në dhomë se po na pengon"²³).


Të anketuarat që kanë përjetuar diskriminim në formë të fjalëve ose imitimit në hapësira publike, ndjejnë një frikë për të lëvizur vetëm. Me këtë, kufizohet edhe liria e tyre e lëvizjes dhe krijohet një presion shtesë për personat që kujdesen për ta (që në shumicën e rasteve janë nëna), në mënyrë që të mos i lënë të vetme. Përfundimisht, gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara që kanë përjetuar diskriminim e dhunë në mjedise të ndryshme, duke filluar nga familja, vendi i punës, institucionet e deri te sektorët publik, kanë pasoja afatgjate që reflektojnë me një nivel të ulët të zhvillimit emocional, mosbesim ndaj personave të tjerë, frikë, nivel të ulët të vetëbesimit dhe izolim nga shoqëria.

²³ Intervistë 44

Një ndër sfidat kryesore përgjatë periudhës COVID-19 për gratë dhe vajzat me AK ishte edhe stabiliteti financiar. Për pjesën më të madhe të të anketuarave (80%), pandemia ka kontribuar për rritjen e shpenzimeve.



Në pyetjen nëse jeni përballur me vështirësi financiare gjatë kohës të pandemisë, pjesa më e madhe e të anketuarave kanë shprehur vështirësi në vazhdimin e shërbimeve shëndetësore, ku 36% kanë rrjedhur me vështirësi në blerjen e ilaçeve dhe medikamenteve të nevojshme. 18% kanë theksuar ndërprerjen e seancave fizioterapeutike, kurse 11% ndaljen e kontrollave mjekësore.



Gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara vetëm se përjetojnë një kosto më të lartë jetese, mirëpo kjo u përforcua nga rritja e kostos së ushqimit, transportit dhe kujdesit shëndetësor gjatë pandemisë. Një shembull u dha për një familje ku kostoja e kontrollave mjekësore u rrit dyfish. Një vizitë në spital apo ordinancë private do të kishte qenë e vështirë financiarisht për ta më parë, por tani ishte e pamundur financiarisht.²⁴ Sfidë e vazhdueshme ka qenë edhe pengesa në marrjen e informacioneve. Informatat të cilat transmetohen nuk janë të përshtatura për personat me aftësi të kufizuara. Mungon thjeshtëzimi i gjuhës, krijimi i versioneve për grupet e aftësisë së kufizuar në të parë apo në dëgjim. Kjo ka rezultuar që edhe në krizën pandemike, kur ka filluar shpërndarja e virusit COVID-19 të mungoj një gjë e tillë dhe të përhapet panika tek personat me aftësi të kufizuar. “E di që e pata përjetu shumë rond. Na si gjeneratë e vjetër meniherë e kem krahasu me luftën.” shprehet njëra nga gratë pjesëmarrëse.²⁵ Jo vetëm që informacionet dhe rekomandimet nuk kanë qenë të thjeshtëzuara, por kanë munguar edhe specifikat rreth aftësisë së kufizuar. Njëra nga vajzat shprehet se si ka qenë e shqetësuar për nënën e saj pasi që ishte e domosdoshme prania e saj si shoqëruese, ndërsa në të njëjtën kohë përmendej vazhdimisht distanca fizike: “Une nuk muna pa dikon që m’përcjellë. Kisha frikë për mamin mos po e gjon najçka”.²⁶ Për shkak të perceptimit të gabuar, shpesh personave me aftësi të kufizuara u mohohet qasja në informacione bazike, përfshirë edhe informacione për gjendjen e tij/saj; informata nga familja, shkolla, apo komuniteti.

Shëndetësia

Kjo pjesë do të diskutojë dhe paraqet sfidat e grave dhe vajzave me AK në marrjen e shërbimeve shëndetësore, dhe besimet e tyre se si mund të avancohet ky lloj shërbimi ndaj PAK.


Gratë dhe vajzat me AK kanë nevoja unike shëndetësore dhe vizitat në institucione shëndetësore i kanë më të shpeshta, por ato kanë më pak gjasa të kenë qasje në shërbime shëndetësore cilësore, ilaçe thelbësore, kujdes shëndetësor riprodhues, ose mbulim sigurimi për shpenzimet rutine shëndetësore, e veçanërisht gratë në rajonet rurale. Normat kufizuese sociale dhe stereotipet gjinore kufizojnë gjithashtu gratë për të pasur qasje në shërbime shëndetësore. Këto janë shprehur edhe më shumë me krizën pandemike, kur këto shërbime ishin shumë të limituara.

²⁴ Intervista ballë për ballë

²⁵ Fokus Grupi IV. 19.05.2022

²⁶ Fokus Grupi IV. 19.05.2022

Kur shikojmë efektet e COVID-19 në personat me aftësi të kufizuara dhe popullatën e përgjithshme, personat me aftësi të kufizuara përballen me pabarazi në shërbimet e kujdesit shëndetësor në krahasim me personat pa aftësi të kufizuara. Marrja e shërbimeve shëndetësore dhe mbrojtja shëndetësore gjatë kohës të pandemisë është realizuar me kufizime për 75% nga të anketuarat. Nga këto kufizime, 62% i referoheshin shërbimeve rehabilituese, 51% shërbimeve të marra nga mjeku specialist, kurse 36% e shërbimeve nga mjeku familjar. 44% janë përballur me vështirësi në qasjen në ilaçe dhe medikamente, kurse 36% në pajisje ortopedike dhe ndihmëse.




Pjesëmarrësit raportuan të kenë pasur përvoja të paragjykitimit dhe diskriminimit nga ofruesit e shërbimeve në institucione shëndetësore. Për shkak të normave sociale që tentojnë të caktojnë që kujdesi dhe puna t'i takojnë gruas, kufizimet kohore mund të ndikojnë në qasjen e gruas në kujdes shëndetësor më tepër se të burrit. Gjetjet e studimit të RrGK tregojnë se, në mesatare, koha e udhëtimit deri dhe nga institucioni shëndetësor zgjat 40 minuta.

Përfshirë edhe kohën e pritjes, diagnostifikimit, trajtimit marrjen e përshkrimit dhe pagesën, një vizitë në institucionin shëndetësor mund të merr shumë kohë.²⁷ U evidentua që nuk ka ndonjë politikë që e rregullon radhën apo pritjen e personave me aftësi të kufizuara "Kjo metët veç qysh don infermierja edhe doktori. Veç nëse ata dojnë të shtijnë pa rend" u shpreh njëra nga gratë pjesëmarrëse që kishte marrë shërbim në QKMF.²⁸

²⁷ Rrjeti i Grave të Kosovës, 2016. *Qasja në kujdesin shëndetësor në Kosovë*


²⁸ Fokus Grup IV, 19.05.2022

VËSHTIRËSITË GJATË MARRJES TË SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE ME TË CILAT JENI PËRBALLUR (ME MUNDËSI PËR PËRZGJEDHJE TË MË SHUMË PËRSGJIGJEVE)




Një tjetër element që u vë në dukje ishte mungesa e funksionimit të reparteve kryesore gjatë pandemisë. Ato përsëritën faktin se personat me aftësi të kufizuara kanë vazhdimisht nevojë për marrje të shërbimeve, e kjo në fillim të periudhës së pandemisë ka munguar. Kështu, pjesëmarrëset në fokus grup njohin persona të cilët gjendja e tyre fizike u është rënduar për shkak të mungesës së funksionimit. "As spitali as Handikosi nuk ka funksionu. As për qato ushtrime fizike që i bojshin nuk ish mundësia".²⁹ 70% e të anketuarve konsiderojnë se është e nevojshme që gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara të kenë përparësi gjatë marrjes të shërbimeve shëndetësore, kurse 25% kanë nevojë për mirëmbajtjen e orareve për kontrollë dhe organizim më të mirë të shërbimeve.

SA JENI TË KËNAQUR ME MARRJEN E SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE?



²⁹ Fokus Grupi IV. 19.05.2022

SIPAS PËRVOJAVE TË JUAJA, ÇFARË DO TË LEHTËSONTE QASJEN NË SHËRBIME SHËNDETËSORE?




Një aspekt tjetër i konfirmuar nga gratë me AK është edhe mungesa e komunikimit të ofruesve të shërbimeve direkt me personin me aftësi të kufizuar, pasi që zakonisht komunikohet me shoqëruesin. Kjo ulë mundësinë për ta kuptuar më mirë shqetësimin e personit me aftësi të kufizuar, por edhe shkon në paragjykim pasi që i konsideron si të paaftë për ta treguar shqetësimin e tyre. Sipas mendimit të të anketuarave, ajo që do të kontribuonte për lehtësim të qasjes në shërbimet shëndetësore dhe ngritjes së kënaqësisë është profesionalizmi i punëtorëve shëndetësor (19%), që përfshin edhe nevojën për komunikim më të mirë të punëtorëve shëndetësor me gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, si dhe sigurimi i infrastrukturës deri te shërbimet nga punëtorët shëndetësor (65%). Rreth 30% e të anketuarave konsiderojnë të domosdoshme vizitat shtëpiake nga punëtorët shëndetësor për persona me aftësi të kufizuar në pamundësi të lëvizjes dhe transportit. Sipas drejtorit të Shëndetësisë në komunën e Mitrovicës, personave me aftësi të kufizuar do të iu lehtësohet qasja në shërbime cilësore shëndetësore që ofrohen në Kujdesin Parësor Shëndetësor, përmes rifunksionalizimit të ashensorit në QKMF, duke shtuar se në bashkëpunim me Drejtorinë për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë, do të rregullohen të gjitha pjerrinat në QMF dhe AMF, aty ku nuk janë funksionale.³⁰

Si përfundim, gratë dhe vajzat me AK u përballën me një llojllojshmëri të sfidave në qasjen e shërbimeve shëndetësore si: mungesa e shërbimeve rehabilituese, rritja e kostos për blerjen e medikamenteve dhe ilaçeve, qasja infrastrukturore, qasja e punëtorëve shëndetësor dhe pritja e gjatë për kontrollat mjekësore.

³⁰ Takim me Drejtorinë e Shëndetësisë. 19.07.2022

Shërbimet sociale


Kjo pjesë përgjigjet në pyetjen mbi përvojat me marrjes së shërbimeve sociale. Një ndër vështirësitë kryesore me të cilat janë hasur është qasja jo e përshtatshme fizike. Si dhe, një pjesë e grave kanë theksuar mbi problemet rreth marrjes dhe ndalesave të pensionit të skemës së aftësisë së kufizuar.



Njëra nga problematikat e identifikuar ishte marrja e shërbimeve sociale në institucionet publike. Gratë pjesëmarrëse në fokus grup shprehën indinjatën e tyre në raport me mungesën e qasjes në këto institucione. Ato deklaruan se për shkak të mungesës së qasjes, janë të detyruara që shërbimet t'i marrin në forma alternative, që përfshijnë: ndihmën e personave të tjerë për t'u ngjitur në katin e dytë; zbritjen e zyrtarëve poshtë, si dhe kryerjen e shërbimeve të tyre në mënyrë private. Unanimisht u dakorduan që krejt këto forma janë diskriminuese. Objekti i Komunës së Mitrovicës Jugore, Qendra për Punë Sociale dhe Departamenti i Pensioneve mbeten institucionet që u përmenden më së shumti nga pjesëmarrëset e të cilat nuk kishin qasje fizike për personat me aftësi të kufizuara. Njëra prej grave në fokus grup përmendi faktin se si ato duhet të ngjiten në katin e dytë në momentet kur duhen të vazhdohet skema e aftësisë së kufizuar. "Çdoherë e kom problem kur kom nevojë me u lajmëru për me vazhdu pensionin e aftësisë së kufizuar. Për komunë s'po flasë hiq".³¹

³¹ Fokus Grupi IV. 19.05.2022

SIPAS PËRVOJAVE TË JUAJA, ÇFARË DO TË LEHTËSONTE QASJEN NË SHËRBIME SOCIALE?



Sipas 28% të anketuarave, qasja e duhur profesionale ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuar, si dhe organizimi dhe funksionalizimi i duhur i administratës janë të nevojshme për përmirësimin e qasjes së shërbimeve sociale. Krijimi i një databaze apo administrate për thjeshtësimin e procedurave për marrjen e shërbimeve sociale konsiderohet i domosdoshëm nga 22% e të anketuarave. Kjo nevojë ka qenë ekzistente edhe në periudhën para krizës së pandemisë COVID-19. Një ndër sfidat kryesore dhe frekvente është edhe kërkesa për ripërtirjen e dokumentacionit të nevojshëm për të dëshmuar vazhdimisht aftësinë e kufizuar. Përgjatë pandemisë COVID-19, ka raste kur në mënyrë arbitrare iu është ndaluar skema pensionale e aftësisë së kufizuar grave dhe vajzave me AK, me pretekstin që nuk janë person me aftësi të kufizuar pavarësisht gjendjes së tyre. “Në mes të pandemisë më është mohu e drejta e pensionit të aftësisë së kufizuar”, ka shprehur vajza me AK.³² Në një anë, flitet edhe për atë se familjet përkujdesëse kanë përfitime, për shkak të kompensimeve për përkujdesje të fëmijëve dhe/ose personave me aftësi të kufizuara, por edhe për shkak të së drejtës në pension. Ndërsa në anën tjetër, prindërit/kujdestarët në shumicën e rasteve zgjedhin që të mos punësohen me qëllim që të kujdesen për personin me aftësi të kufizuar. Sipas QPS në Mitrovicë, janë rregullatorët dhe ligjet e Republikës së Kosovës të cilat janë në zbatim dhe nuk mundën të ndryshohen në nivel lokal.³³

³² Fokus Grupi I. 07.05.2022

³³ Takim me QPS-në në Mitrovicë. 14.07.2022

Punësimi

Kjo pjesë diskuton se si pandemia COVID-19 e ka përkeqësuar më tej situatën e grave me AK në tregun e punës. Mbyllja e shkollave, masat e izolimit dhe ngarkesa e shtuar e punës përreth familjes për shkak të kësaj situatë kanë ndikuar negativisht te gratë e punësuar.

Në rrethana normale, gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara përballen me pengesa të ndryshme sistematike që kufizojnë qasjen e tyre në punë të denjë. Për shembull, vajzat me aftësi të kufizuara kanë më pak gjasa se bashkëmoshatarët e tyre meshkuj me aftësi të kufizuara për të ndjekur shkollën, duke i bërë ato më pak gjasa për të gjetur punë formale. Dhuna në familje dhe përkeqësimi i përgjithshëm i shëndetit mendor dhe emocional, i cili është regjistruar globalisht si dhe në Kosovë, përfaqëson një aspekt tjetër që ka prekur negativisht gratë.


Ligji i Kosovës përfshin masa afirmative për punësimin e personave me aftësi të ndryshme; çdo institucion shtetëror, punëdhënës në sektorin privat dhe organizatë e shoqërisë civile (OSHC), duhet të punësojë të paktën një person me aftësi të ndryshme, për çdo 50 punonjës³⁴. Punësimi i personave me aftësi të kufizuara historikisht ka mbetur i ulët dhe sfidues. Pavarësisht përpjekjeve që çështja e punësimit të rregullohet edhe me Legjislacion, punëdhënësit kanë hezitur ta implementojnë një gjë të tillë. Përfaqësuesit e OSHC-ve vazhdimisht theksuan se janë të paktë personat me aftësi të ndryshme, të cilët ishin punësuar, sidomos gratë.³⁵

Për shkak të aftësisë së kufizuar dhe gjinisë së tyre, gratë me aftësi të kufizuara përballen me diskriminim të dyfishtë në aplikimet e tyre për punë. Andaj, nuk është e papritur që nga të anketuarat, vetëm 19% e grave ishin në marrëdhënie pune gjatë pandemisë COVID-19. Gjithashtu, rreth gjysma e tyre, ishin edhe të lidhur me mungesë në vendin e punës si rrjedhojë e izolimit dhe për shkak të mbrojtjes nga virusi. Duke pasur parasysh se personat me aftësi të kufizuara edhe para krizës pandemike janë përballur me vështirësi në qasje në tregun e punës, ky problem veçse është rritur, duke përfshirë edhe rrezikun e humbjes së vendit të punës, si dhe vështirësitë e kthimit në vendin e punës.

³⁴ Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara. <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2620>

³⁵ Rrjeti i Grave të Kosovës, 2022. *Diskriminimi me bazë gjinore dhe punësimi në Kosovë*. https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2022/04/RrGK_Diskriminimi-me-Baze-Gjinore-dhe-Punesimi_2022-2.pdf

VËSHIRËSITË GJATË PANDEMISË COVID-19 NË LIDHJE ME PUNËSIMIN?



OSHC-të që punojnë me persona me aftësi të ndryshme thanë se pjesa më e madhe e rasteve dëshmojnë se kanë të bëjnë me diskriminimin e pranimit në punë, pavarësisht se aplikantët kanë kualifikimet e përshtatshme, si dhe diskriminimi në ngritjen në detyrë. Ishin të pakta shembujt specifik të diskriminimit me bazë eksplicite gjinore; në vend të kësaj, ata prireshin të flisnin në vija më të përgjithshme për diskriminimin kundër personave me aftësi të ndryshme për shkak të aftësisë së tyre.³⁶ Njëra nga pjesëmarrëset në fokus grup tregoj se si personat me aftësi të kufizuara janë paragjykuar kur ata kanë aplikuar për një vend pune në një prej marketeve në Mitrovicë. “Ajo (menaxherja) e ka potencu tri herë faktin se na duhet ta lëmë telefonin e hapur në rast se ju thërrasim për intervistë apo punësim. As e-mailin nuk na e kanë kërku.”³⁷ Ky shembull tregon për paragjykimin që menaxherja ka karshi personave me aftësi të kufizuara, duke i menduar si të papërgjegjshëm dhe që nuk kanë qasje në e-mail.

Sipas ligjit, për çdo 50 punëdhënës në një institucion publik duhet të ketë të paktën një person me aftësi të kufizuara, por ky ligj nuk zbatohet nga institucionet publike. Në kohën aktuale në rajonin e Mitrovicës, vetëm katër (4) gra me aftësi të kufizuara janë të punësuar në institucione publike.³⁸ Gratë dhe vajzat me AK përmendën edhe disa nga shembujt dhe institucionet prej ku kanë filluar sfidat e tyre, që nga institucionet shkollore, mësuesit, e deri tek kërkesa për vendin e punës. Njëra nga gratë pjesëmarrëse në fokus grup tregoi për kontrollet fizike që ajo u është nënshtruar gjatë aplikimit për punë në një fabrikë. “Dy herë i kom pasë kontrollet

³⁶ Rrjeti i Grave të Kosovës, 2022. *Diskriminimi me bazë gjinore dhe punësimi në Kosovë*. https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2022/04/RrGK_Diskriminimi-me-Baze-Gjinore-dhe-Punesimi_2022-2.pdf

³⁷ Fokus Grupi I. 07.05.2022

³⁸ Databaza e anëtarëve të Handikos Mitrovica, 2022

fizike. Dytën herë ma kanë bo veç mu, masi që kam qenë kandidatja e vetme me aftësi të kufizuara.” Sidoqoftë, ajo potencoj faktin se pas një kohe pasi që ajo është punësuar për shkak të përkushtimit të saj të lartë është shpallur edhe punëtorja më e dalluar. Ajo shprehet se shoqëria do të filloj t’i zbusë paragjykimet në momentin kur personave me aftësi të kufizuara ju ofrohet mundësia për ta prezantuar veten.³⁹

Si përfundim, gratë me aftësi të kufizuar vazhdojnë të përballen me sfidën e qasjes në tregun e punës, dhe mbajtjen e një pune të denjë për to.

Arsimi

Kjo pjesë diskuton mbi barrierat me të cilat fëmijët dhe të rriturit me AK janë përballur për të pasur një arsim cilësor. Një ndër temat më të përsëritura është mungesa e asistentëve mbështetës në shkollat e Mitrovicës, si dhe mungesa e pajisjeve të duhura mësimore.


Personat të cilët kujdesen për FAK theksojnë se pengesa më serioze me të cilën janë përballur fëmijët me aftësi të kufizuara në procesin arsimor në komunën e Mitrovicës është mungesa e asistentëve mbështetës. Ky problem ka qenë prezent edhe para pandemisë COVID-19, mirëpo arsimi i fëmijëve me aftësi të kufizuar përgjatë COVID-19 mund të themi që ka qenë jo-ekzistent.

Theksohet se pengesat për personat me aftësi të kufizuara në procesin arsimor rrjedhin nga ajo se ata edhe nuk kanë qasje në teknologjinë përkatëse ndihmëse, kurse për një pjesë të fëmijëve (60%) problem është edhe mungesa e qasjes individuale gjatë realizimit të planit të tyre individual, që nënkupton se fëmijët me aftësi të kufizuara nuk kanë marrë ndihmë nga shërbimi profesional.


Është e vërejtur që gjatë përgatitjes dhe miratimit të masave, Ministria e Arsimit, Teknologjisë dhe Inovacionit nuk ka shqyrtuar sfidat që mësimi online ka vendosur për fëmijët me aftësi të kufizuara. Një pjesë e këtyre sfidave i referohen mungesës të pajisjes përkatëse për mësim online, kjo që pamundëson realizimin e planeve individuale arsimore; mospërshtatje të mësimdhënies online ndaj personave me lloje të ndryshme të aftësive të kufizuara; mungesës të teknologjisë ndihmëse; mungesës të asistentëve mbështetës dhe kuadrit mësimor për mbështetjen e fëmijëve për ndjekjen e mësimin nga shtëpia. Kjo mënyrë tregon në atë se qeveria nuk ka përmbushur detyrimet e saj në pajtim me Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, që është respektimi i të drejtës për mbrojtje të

³⁹ Fokus Grupi I. 07.05.2022

domosdoshme dhe ndihmë nga shoqëria dhe shteti për të gëzuarit e plotë dhe të barabartë të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.



Me qëllim të tejkalimit të vështirësive me të cilat janë përballur në procesin arsimor, të anketuarat kanë theksuar se veçanërisht është e domosdoshme mbështetja gjatë ndjekjes të mësimit nga ana e asistentit mbështetës. 24% e të anketuarve kanë theksuar mësimin me prani fizike dhe nevojën për pajisje më përkatëse dhe mjete ndihmëse për ndjekjen e mësimit, kurse 18 % kanë theksuar programin më të mirë për mësim të përshtatur në mënyrë përkatëse për fëmijët me aftësi të kufizuara.



Gjithashtu, është bërë krahasimi i arsimit mes dy periudhave të ndryshme të kohës. U vë në theks fakti që shkollimi i personave me aftësi të kufizuara dhe i grave në mënyrë më specifike ka qenë shumë më i vështirë në të kaluarën se sa tash. “Na me zor e kemi pasë gjithëçkafin, menzi shkollën fillore që e kemi kry.”⁴⁰ shprehet njëra nga pjesëmarrëset në fokus grup. Ajo tregoj se si kishte vijuar shkollën e rregullt me sfida të shumta në paragjykime nga mësuesit. Ajo u shpreh që ka qenë me fat që afër nuk ka pasur ndonjë shkollë speciale, përndryshe as që do të diskutohej shkollimi i rregullt.

Meqenëse procesi i kalimit nga shkollimi special në atë të rregullt është intensifikuar pas vitit 2010, atëherë edhe kur Ministria e Arsimit fillon të zbatoj indeksin për gjithëpërfshirje, këtij procesi i janë dashur me vite që të kuptohet dhe të zbatohet nga zyrtarët e shkollave. Këtë e pohoj edhe njëra nga pjesëmarrëset më të reja, e cila njëkohësisht e ka përjetuar procesin e transformimit dhe të kalimit nga edukimi special në atë të rregullt. “Jom kon në Qendër Burimore edhe pse kom veç probleme fizike, ne dy shkolla u dashtë me provu deri sa me kanë pranë në Bedri Gjinaj.”⁴¹ Ajo u shpreh se si Drejtori i njëres prej shkollave kishte refuzuar ta pranë atë duke pasur keqkuptime të tmerrshme rreth aftësisë së kufizuar, ndërsa Drejtori që e kishte pranuar kishte bërë çmos që ajo të ndjehej e përfshirë aty. Frikë për prindërit e saj kanë qenë ekspozimi i saj në ngacmimet e bashkëmohatarëve në shkolla. Ajo tregoj se si në fakt edhe prindërit kishin qenë kundër kalimit në shkollë të rregullt pikërisht duke e pasur këtë frikë. “Nxënëset në shkollë nuk më kanë ngacmu, veç me kanë pytë kaniher edhe me prindët e tyne çka kom edhe me kanë shiku si ma e vogël edhe gjynah.”⁴²

Fëmijët me aftësi të kufizuar kanë të drejta të barabarta me të gjithë fëmijët tjerë, bazuar në kushtetutë dhe ligje. Secili fëmijë gëzon të drejtën e shkollimit bazë pa pagesë dhe institucionet publike duhet të sigurojnë mundësi të barabarta për t’u arsimuar, sipas aftësive dhe nevojave të veçanta të fëmijëve. Fëmijët me AK gjithashtu kanë të drejtën e transportit. Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, parasheh të drejtën e fëmijëve me aftësi të kufizuara për transport, ku pika 4 e Nenit 40-të përcakton; sipas vlerësimeve individuale profesionale, komunat sigurojnë transport falas, të sigurt dhe të përshtatshëm për fëmijët me aftësi të kufizuara apo me vështirësi në mësim që ndjekin mësimet në shkollë komunale.⁴³ Ky shërbim në komunën e Mitrovicës nuk është funksional që

⁴⁰ Fokus Grupi II. 12.05.2022

⁴¹ Fokus Grupi II. 12.05.2022

⁴² Fokus Grupi II. 12.05.2022

⁴³ Ligji Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar, 2011. Republika e Kosovës <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2770>

nga fillimi i krizës pandemike, me shpjegim të mungesës së fondeve të nevojshme për implementim të duhur dhe të drejtë.⁴⁴

Bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr.26/2013 për zgjedhjen e nëpunësve për ofrimin e shërbimeve profesionale në institucionet edukative-arsimore para-universitare, në Nenin e 3-të dhe 4-të parashihet punësimi i domosdoshëm i shërbyesit profesional dhe psikologut në institucione edukative- arsimore të cilat arrijnë numrin mbi 1000 nxënës/fëmijë.⁴⁵ Mirëpo, si shumë të tjerë ky ligj nuk gjen zbatim në shkollat në komunën e Mitrovicës.

Si përfundim, problematikat e arsimit për aftësinë e kufizuar në komunën e Mitrovicës janë mjaft sfiduese. Mos-respektimi i ligjeve ka qar në diskriminimin e fëmijëve dhe të rriturve me aftësi të kufizuar në aspektin arsimor nga vetë institucioni i cili është i obliguar për të i mbështetur.

⁴⁴ Takim me Drejtorinë Komunale të Arsimit. 20.07.2022

⁴⁵ Udhëzimi Administrativ MASHT Nr.26/2013. Neni 3 dhe 4.

MONITORIMI I MASËS 1.6 TË PAKOS SË RINGJALLJES EKONOMIKE

Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar rezolutën që viti 2022 të shpallet vit i personave me aftësi të kufizuara. Me shpalljen e vitit 2022, Ministritë, OPAK dhe shoqëria në përgjithësi synojnë të mobilizojnë resurset e tyre për të trasuar rrugën për një Kosovë pa pengesa dhe për të fuqizuar personat me aftësi të kufizuara, në mënyrë që ata të mund të gëzojnë të drejta të barabarta dhe të marrin pjesë plotësisht në të gjitha sferat e shoqërisë.

Masa 1 e Pakos së Ringjalljes Ekonomike, e cila ka për qëllim mbështetjen e punësimit, në mënyrë që të minimizojë ndikimin negativ të pandemisë COVID-19, por edhe të shërbejë si mënyrë për krijimin e vendeve të reja të punës, e mbi të gjitha formalizimin e punësimit. Tregu i punës në Kosovë, edhe para pandemisë COVID-19 ka qenë i pabarabartë, duke i shpërfaqur pabarazitë në mes të grave dhe burrave, grupeve etnike, por edhe duke lënë rininë në margjina të tregut të punës.

Nënmasa 1.6 specifikisht ka për qëllim mbështetjen e punësimit të personave me aftësi të kufizuara, në vlerë prej 5 milionë euro. Me qëllim të adresimit të pabarazive në tregun e punës dhe ofrimit të mundësive të barabarta për personat me aftësi të kufizuara, kjo nënmasë parasheh subvencionimin e 50% të pagës (deri në maksimum € 150 në muajt), për 6 muajt e parë të punësimit të personave me aftësi të kufizuara.⁴⁶


Implementimi i masës 1.6 synon aftësimin profesional të personave me aftësi të kufizuara, që të jenë të barabartë në punësim dhe të ofrohet qasje jo-diskriminuese në tregun e punës. Aftësimi profesional realizohet përmes trajnimeve që zhvillohen në shoqëri tregtare (biznese) ose entitete, të cilat identifikohen nga OJQ-të që zgjedhën për implementimin e Masës 1.6. Më pas biznesi ose entiteti ku është realizuar trajnimi mund të lidhë marrëdhënie të rregullt pune me të trajnuarit, ku edhe për punësimin e të trajnuarve do të ketë mbështetje përmes kësaj mase.

Derisa nënmasa 1.6 është ende në zbatim dhe nuk ka të dhëna zyrtare për nivelin e zbatimit, duke qenë që aplikimi për OJQ-të të cilat kualifikohen për mbështetje ka qenë i hapur deri në Prill 2022. Si rezultat, të dhënat për zbatimin e kësaj nënmasë, përveç numrit të PAK apo OJQ-ve, duhet po ashtu të parashohin gjurmimin e ndikimit të këtyre investimeve në mënyrë që të vlerësohet ndikimi real.


⁴⁶ Pakoja e Ringjalljes Ekonomike. Qershor 2021. <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/D3A6FA8F-6A6A-42AA-A090-52062568DC47.pdf>

Për të vlerësuar ndikimin e masës 1.6 të Pakos së Ringjalljes Ekonomike tek gratë me aftësi të kufizuara specifiku, duhet të mblidhen dhe të publikohen të dhëna në kohën reale edhe mbi ndarjen në barazi gjinore. Mirëpo, edhe pse me 11 Gusht 2022 është njoftuar mbi nënshkrimin e marrëveshjeve në mes të OJQ-ve dhe Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve mbi zbatimin e masës në fjalë, nuk është publikuar lista preliminare apo përfundimtare e OJQ-ve përfituese. Si rrjedhojë, mungojnë të dhëna konkrete mbi ndikimin e masës tek punësimi i personave me aftësi të kufizuara.


Në pyetjen se nëse ishin të informuar mbi mundësinë e aplikimit të thirrjes së qeverisë për masën 1.6 të pakos për Mbështetjen e punësimit për persona me aftësi të kufizuara, 39% e të anketuarave u përgjigjen që kishin qenë të informuara. Ndërsa, 61% u shprehën që nuk kishin njohuri mbi këtë masë.



Prej 39% të grave që kishin njohuri mbi masën 1.6, 25% kanë marrë informacionin nga rrjetet sociale dhe 12% nga organizatat joqeveritare. Sipas të anketuarave, ndër metodat më të denja për informimin e PAK janë rrjetet sociale të institucioneve dhe OJQ-të.



Në mënyrë shqetësuese, 62% e grave dhe vajzave me aftësi të kufizuar nuk kanë pasur interes për thirrjen e qeverisë në kuadër të masës 1.6 për Mbështetjen e punësimit për persona me aftësi të kufizuar. Kjo vjen si pasojë e zhgënjimit të vazhdueshëm dhe mosbesimit ndaj institucioneve qendrore. "Nuk em bohet mu edhe me dashtë, i shtijnë njerz e vetë" u deklarua njëra nga vajzat me AK.⁴⁷



Gjithëpërfshirja mbetet ende problem i madhë në Kosovë. Edhe pse Qeveria përmes Pakos së Ringjalljes Ekonomike ka paraparë disa masa që përmirësojnë gjithëpërfshirjen, pabarazitë në nivele të ndryshme mbasin të dukshme dhe duhet të adresohen me anë të politikave afatgjate.

⁴⁷ Intervistë 14

KONKLuzionet dhe Rekomandimet

Qeveria lokale dhe nacionale nuk ka respektuar obligimet që rrjedhin nga Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, sidomos atyre në raporte me përfshirjen aktive të grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara në proceset e marrjes të vendimeve për politikën dhe programet; vlerësimin e rëndësisë të qasjes deri te mjedisi fizik, social, ekonomik dhe kulturor, deri te shëndetësia dhe arsimi, si dhe tek informimi dhe komunikimi; si dhe ndërmarrjen e gjitha masave të nevojshme për mbrojtjen dhe sigurinë e grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara në situata të rrezikut, duke përfshirë edhe gjendjet e jashtëzakonshme siç është pandemia COVID-19.

Buxhetimi lokal financiar

Pjesa më e madhe e grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara janë përballur me rritjen e shpenzimeve të përditshme, nga të cilat më së shumti i janë referuar shpenzimeve për mjete higjienike, duke përfshirë edhe mjetet për mbrojtjen nga virusi, shpenzimet për ilaçe dhe shpenzimet për ushqim. Nevoja për prokurimin e suplementeve, siç janë vitaminat më të rëndësishme, për parandalim, por edhe për trajtim të virusit, të cilat nuk ndodhen në listën pozitive të ilaçeve të Fondit për sigurim shëndetësor, në mënyrë shtesë kanë rritur shpenzimet e personave me aftësi të kufizuara. Për ata të cilët terapinë e nevojshme e sigurojnë jashtë shtetit, mbyllja e kufijve dhe kufizimet për tejkalimin e tyre kanë imponuar shpenzime të reja.

Për përmirësimin e gjendjes financiare të grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara, nevojitet:

- ▶ Sigurimi i mjeteve higjienike;
- ▶ Sigurimi i ilaçeve dhe suplementëve, si dhe terapi specifike, e cila nuk është në listën pozitive dhe/ose futjen e tyre në listën pozitive të ilaçeve të Fondit për sigurim shëndetësor;
- ▶ Miratimi i masave për ndihmë shtetërore financiare për personat me aftësi të kufizuara, si dhe zgjerimi i shtrirjes të tyre edhe mbi personat me aftësi të kufizuara të cilët nuk janë të aftë për punë;
- ▶ Në mungesë të shërbimeve sociale ekzistuese në QPS dhe DIEMS, rekomandohet të krijohet një linjë buxhetore për blerjen e këtyre shërbimeve me staf profesional në organizata të licencuara për ofrimin e shërbimeve në fjalë.

Shëndetësia

Gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara janë përballur me një numër të madh të kufizimeve gjatë përdorimit të shërbimeve shëndetësore. Personat me aftësi të kufizuara dhe personat që kujdesen për to janë përballur me fluks dhe pritje të rradhëve në institucionet shëndetësore, kurse kjo në mënyrë serioze ka rritur rrezikun e infektimit me virus. Në mënyrë shtesë, duke marrë parasysh se një pjesë e personave me aftësi të kufizuara kanë vështirësi në raport me respektimin e masave për mbrojtjen nga virusi, siç është për shembull, mbajtja e maskës, rreziku nga infektimi mund të rritet në mënyrë të konsideruar për to, por edhe për personat tjerë.

Institucionet shëndetësore kanë qenë të vendosura tërësisht në funksion mbi tejkalimin e pasojave nga pandemia COVID-19, dhe të gjitha kontrollat tjera të vazhdueshme dhe intervenimet ishin shtyrë. Shërbimet për rehabilitim (duke përfshirë edhe seancat fizioterapeutike) të cilat janë të rëndësishme të veçantë për personat me aftësi të kufizuara dhe ndikojnë pozitivisht mbi zhvillimin e tyre, ishin të pamundura. Përveç asaj, gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara dhe personat të cilët kujdesen për to kanë shprehur pakënaqësi në raport me profesionalizimin e punëtorëve shëndetësor dhe mënyrën e komunikimit të ndërsjellë, duke theksuar edhe mosdurimin dhe mosnjohjen e nevojave specifike të cilat i kanë.

Me qëllim që të përmirësohet qasja në shërbimet shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara dhe të sigurohet mbrojtja më e mirë shëndetësore, nevojitet:

- ▶ Personat me aftësi të kufizuara të kenë përparësi gjatë dhënies të shërbimeve të mbrojtjes shëndetësore, sidomos të atyre që nuk kanë mundësi për shkak të gjendjes të tyre të presin kohë të gjatë dhe/ose në mënyrë përkatëse të respektojnë masat e mbrojtjes;
- ▶ Kthimi në funksion i shërbimeve fizioterapeutike në pajtim me protokollet për mbrojtje nga virusi;
- ▶ Të ngritet vetëdija e punëtorëve shëndetësorë për punën me personat me aftësi të kufizuara dhe përmirësimin e mënyrës të komunikimit me personat me aftësi të kufizuara, duke marrë parasysh nevojat e tyre specifike;
- ▶ Të krijohet një data bazë e të dhënave që sa persona me aftësi të kufizuara janë duke marrur shërbime shëndetësore, evidencë e gjeneruar e të dhënave, për llojin e aftësisë dhe llojin e shërbimit që ata përfitojnë ata brenda vitit;
- ▶ Të krijohen dispozita për vazhdimin e shërbimeve standarde shëndetësore, veçanërisht për kujdesin shëndetësor seksual dhe riprodhues.

Shërbimet sociale

Masat për parandalimin dhe mbrojtjen nga virusi korona u kanë shkaktuar vështirësi në funksionimin e përditshëm grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara. Në masë të madhe, ato vështirësi i referohen socializimit të kufizuar dhe lëvizjes të kufizuar, si dhe vështirësive të lidhura me mbajtjen e masave për mbrojtje nga virusi (mbajtjen e distancës fizike, mbajtjen e maskës, shmangies të grupimeve etj.). Gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara dhe personat që kujdesen për to janë përballur me vështirësi në realizimin e të drejtave të tyre gjatë pandemisë, prej të cilëve vetëm një grup i vogël janë drejtuar për ndihmë më së shpeshti në qendrat për punë sociale, kurse një numër më i vogël kanë kërkuar ndihmë nga organizatat joqeveritare.

Në drejtim të përmirësimit të qasjes të personave me aftësi të kufizuara në të drejta dhe shërbime, propozojmë:

- ▶ Qendrat për Punë Sociale të jenë të qasshme, të disponueshme dhe të përgjigjen në mënyrë përkatëse në kërkesave të grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara të cilat kujdesen për to, duke pasur parasysh se qendrat janë ndër akterët më të rëndësishëm të cilët më të shpeshti drejtohen palët e përfshira;
- ▶ Harmonizimi dhe praktika e zbatimit të dispozitave që i referohen personave me aftësi të kufizuara;
- ▶ Të thjeshtësohet procesi i marrjes së pensionit të skemave të aftësisë së kufizuar;
- ▶ Ngritja e vetëdijës për zbatimin e masave për të mbrojtur personat me aftësi të kufizuara dhe ata me dobësi që jetojnë në mjedise institucionale me rrezik të shtuar të neglizhencës, kufizimit, izolimit ose braktisjes në objektet e banimit të ndikuar nga COVID-19, duke e bërë komunikimin gjithëpërfshirës dhe mesazhet e shëndetit publik të aksesueshëm, përfshirë përmes gjuhës së shenjave interpretimi, përdorimi i tekstit në gjuhë të thjeshtë dhe formate të lehta për t'u lexuar;
- ▶ Në pjesën e përgjegjësive obligative të Drejtorisë së Mirëqenies Sociale ndër të tjera është edhe pika ku përmendet se kjo drejtori bën përkujdesjen e vazhdueshme ndaj familjeve të dëshmorëve, invalidëve dhe veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe anëtarëve të familjeve të tyre që e kanë këtë status, familjeve të të zhdukurve, Shoqatën e Handikos Mitrovica, Shoqatën e Shurdhmemecëve dhe Shoqatën e të Verbërve, me qëllim të realizimit të të drejtave dhe beneficioneve të posaçme, që janë në kompetencë të Komunës. Rekomandohet të implementohet në masa më të gjera ky obligim nga DIEMS;

- ▶ Të rritet bashkëpunimi në mes të QPS-së, DIEMS-it, Zyrës për Barazi Gjinore, dhe Zyrës për të Drejtat e Njeriut për avancimin e të drejtave të grave dhe vajzave me AK, si dhe të implementojnë barazinë gjinore në këto institucione.

Arsimi

Fëmijët me aftësi të kufizuara janë përballur me sfida dhe vështirësi gjatë pandemisë COVID-19, pasi që mësimi nuk ishte i përshtatur për llojet e ndryshme të aftësive të kufizuara. Realizimi i mësimit zhvillohej në mungesë të mjeteve përkatëse ndihmëse arsimore.

Gjithashtu, në rajonin e Mitrovicës ekziston nevoja për funksionimin e Ekipit Vlerësues Pedagogjik dhe hartimin e planeve individuale arsimore të fëmijëve me aftësi të kufizuara në koordinim me DKA-në, QPS-në, shkollat dhe prindërit. Fatkeqësisht, për shkak të mungesës së kompensimit material dhe angazhimeve në punën e tyre parësore, ekipi ka ndërprerë funksionimin.

Rrjedhimisht, në fushën e arsimit është e nevojshme:

- ▶ Të ngritet numri i mësuesëve mbështetës dhe asistentëve profesional në shkolla për përkrahje në ndjekjen e mësimit me prani fizike apo online;
- ▶ Përshtatja e programeve arsimore në pajtim me nevojat e fëmijëve dhe zhvillimin e planeve individuale të arsimit;
- ▶ Realizimi i mësimit në mënyrë përkatëse me nevojat e personave me aftësi të kufizuara, dhe kjo nënkupton përshtatjen e nevojave specifike të nxënësve;
- ▶ Sigurimi i teknologjisë përkatëse ndihmëse dhe mjete ndihmëse arsimore për nxënësit me aftësi të kufizuara që kanë nevojë për to;
- ▶ Funkcionalizimi i Ekipit Vlerësues Pedagogjik në Komunën e Mitrovicës, dhe ngritja e kapaciteteve të ekipit.

Punësimi dhe zbatimi i masës 1.6 të PRE

Ligji 03/L-019 për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara i obligon institucionet publike dhe private që të punësojnë një PAK për çdo 50 të punësuar.⁴⁸ Edhe pse korniza ligjore vlerësohet të ketë disa dispozita plotësuese për integrimin e personave me aftësi të kufizuar në tregun e punës, megjithatë, sikurse me shumë ligje në Kosovë, situata në praktikë lë për të dëshiruar. Përfshirja e grave në punësim dhe procese vendimmarrëse, si në sektorin

⁴⁸ Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara. <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2620>

publik ashtu edhe në atë privat, mbetet një sfidë kryesore. Pabarazia e rrënjosur thellë gjinore krahas diskriminimit për shkak të aftësisë së kufizuar i pengon gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara të kontribuojnë dhe të ndikojnë në programet e zhvillimit.

- ▶ Pasi që është shpallur Viti 2022 – Vit i Aftësisë së Kufizuar, rekomandohet që qeveria lokale dhe qendrore të krijojë thirrje publike për punësimin e PAK në institucionet publike që të zbatohet Ligji 03/L-019 për punësimin e çdo të 50 një person me aftësi të kufizuar;
- ▶ Për zbatimin e masës 1.6 rekomandohet që MFPT të konsultojë me OPAK mbi kriteret e bizneseve dhe organizatave të cilat aplikojnë për kyçjen e personave me AK në tregun e punës;
- ▶ Monitorimi i zbatimit të masës 1.6 të PRE tek bizneset dhe OJQ-të për implementimin e duhur dhe punësimin e drejtë të PAK;
- ▶ Të inkurajohen gratë dhe vajzat me AK përmes thirrjeve të dedikuara për punësimin e tyre, dhe ngritjen e kapaciteteve të nevojshme për punë.

BURIMET E CITUARA

Organizata Botërore e Shëndetësisë (2020, mars). *WHO Director-General's opening remarks at the media briefing on COVID-19 - 11 March 2020*:

<https://www.who.int/dg/speeches/detail/who-director-general-s-opening-remarks-at-the-media-briefing-on-COVID-19---11-march-2020>

Organizata Botërore e Shëndetësisë (2020). *Timeline: WHO's COVID-19 response*. [Timeline of WHO's response to COVID-19](#)

Organizata Botërore e Shëndetësisë (16 mars, 2020). Disability considerations during the COVID-19 outbreak. [Disability considerations during the COVID-19 outbreak \(who.int\)](#)

Organizata e Kombeve të Bashkuara (23 prill, 2020). COVID-19 and Human Rights - We are all in this together. [UNSDG | COVID-19 and Human Rights: We are all in this together](#)

Popovska, zh. (2018) Interpretues i Konventës ndërkombëtare për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Polio plus – Shkup, fq. 14

Konventa për Rehabilitimin Profesional dhe Punësimin (Personat me aftësi të kufizuara) Konventa, 1983 (Nr. 159)

Komiteti për të Drejtat e Personave me aftësi të Kufizuara. [1620871 \(un.org\)](#)

Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, 1948, [Universal Declaration of Human Rights | United Nations](#)

Strategjia Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2013/23.

http://handi-kos.org/wp-content/uploads/2004/03/strategjia_nacionale_finale_per_shtyp_3_gjuhet_bardh_e_zi_88_013-2.pdf

HANDIKOS. Standardet ndërkombëtare mbi çështjet e aftësisë së kufizuar: Ku qëndron Kosova?. Mars 2020 http://handi-kos.org/wp-content/uploads/2004/05/Report_SHQ-29_04_20_95548.pdf

Komision Evropian. Raporti i Kosovës 2021

Disability and Health, Janar, 2018. World Health Organization (WHO)

Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara. <https://gzk.rks.gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2620>

Ligji nr. 04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=9517>

Rrjeti i Grave të Kosovës, 2016. *Qasja në kujdesin shëndetësor në Kosovë*

Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara. <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2620>

Rrjeti i Grave të Kosovës, 2022. *Diskriminimi me bazë gjinore dhe punësimi në Kosovë*. https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2022/04/RrGK_Diskriminimi-me-Baze-Gjinore-dhe-Punesimi_2022-2.pdf

Ligji Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar, 2011. Republika e Kosovës <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2770>

Pakoja e Ringjalljes Ekonomike. Qershor 2021. <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/D3A6FA8F-6A6A-42AA-A090-52062568DC47.pdf>

SHTOJCA 1. Pyetësi

PYETËSOR ANKETUES

Të nderuara,

Qëllimi i këtij hulumtimi është dokumentimi i sfidave dhe ballafaqimeve të grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara, si dhe nënave të fëmijëve me aftësi të kufizuar në komunën e Mitrovicës.

Rezultatet nga ky hulumtim do të shërbejnë për propozimin e rekomandimeve ndaj institucioneve përkatëse dhe qeverisë për avancimin e shërbimeve sociale për persona me aftësi të kufizuar.

Ne shpresojmë se do të hasim në mirëkuptimin tuaj dhe do të gjeni kohë për t'u përgjigjur në pyetjet e parashtruara në këtë pyetësor. Pyetësi mbetet anonim për opinion, pra emri juaj dhe të dhënat që përmban anketa në asnjë rast nuk do të paraqiten e as të prezantohen në publik. Ju jeni zgjedhur të jeni njëri/a ndër të anketuarat - sipas metodës së rastit (ngjashëm me mënyrën si nxjerrren numrat në lojën e lotarisë).

Ju falënderojmë paraprakisht për gatishmërinë tuaj!

Shoqata e Personave me Aftësi të Kufizuar – Handikos Mitrovica

Kush po i përgjigjet këtij pyetësori?

Personi me aftësi të kufizuara	<input type="checkbox"/>
Anëtar i familjes së një personi me aftësi të kufizuara	<input type="checkbox"/>
Kujdestari i një personi me aftësi të kufizuara	<input type="checkbox"/>
Tjetër (specifikoni)	

I. Detaje të përgjithshme

Emri dhe mbiemri
Grupmosha
<input type="checkbox"/> 0 – 17 vjeçarë
<input type="checkbox"/> 18 – 24 vjeçarë
<input type="checkbox"/> 25 – 44 vjeçarë
<input type="checkbox"/> 45 – 64 vjeçarë
<input type="checkbox"/> + 65 vjeçarë
Vendi i lindjes
Seksi
Mashkull <input type="checkbox"/> Femër <input type="checkbox"/>
Statusi martesor
Beqar/e <input type="checkbox"/> I/e martuar <input type="checkbox"/> I/e divorcuar <input type="checkbox"/> I/e ve <input type="checkbox"/>
Vendbanimi (adresa / qyteti)
Numri i telefonit
Email adresa

A. Gjendja Shëndetësore

1. Zgjidhni specifikën që përshkruan më saktë gjendjen tuaj?		
<input type="checkbox"/> Dëmtim pamor (shikimi)		
<input type="checkbox"/> Dëmtim dëgjimor (dëgjimi)		
<input type="checkbox"/> Dëmtim në të folur (individ pa zë)		
<input type="checkbox"/> Dëmtim në aspektin njohës (të menduarit, të kuptuarit, të mësuarit)		
<input type="checkbox"/> Dëmtim fizik		
<input type="checkbox"/> Tjetër (specifikoni më poshtë):		
2. Shkaku (Origjina) e gjendjes suaj?		
<input type="checkbox"/> Që nga lindja		
<input type="checkbox"/> Pas lindjes		
<input type="checkbox"/> Çrregullim i trashëguar		
<input type="checkbox"/> Sëmundje		
<input type="checkbox"/> Aksident		
<input type="checkbox"/> Lufta		
<input type="checkbox"/> Tjetër (specifikoni më poshtë):		
3. Lëvizshmëria. Zgjidhni aktivitetet që mund të kryeni		Po
Përdorni duart dhe krahët (tërheq, shtyj, hedh)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Dora e majtë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Dora e djathtë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Përdorni këmbët (ngjit, vrapo, kërcë)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Drejtoni një automjet (veturë, biçikletë)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
4. Cilat nga mjetet ndihmëse të mëposhtme i përdorni për	Po	Jo
Karrocë manuale	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Karrocë elektrike	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Karroce tualeti	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Shëtitore	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Paterica	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Proteza	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Këpucë ortopedike	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Proteza (Orthosis)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Mbajtëse	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
5. Vetë-kujdesi. Zgjidhni aktivitetet që mund të kryeni:	Po	Jo

Laheni me ndihmë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Shkoni në tualet me ndihmë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Visheni dhe zhvisheni me ndihmë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Hani dhe pini me ndihmë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

6. Komunikimi:		Po
Flisni me vështirësi	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Komunikoni me pajisje ndihmëse	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Komunikoni me gjuhën e shenjave	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

7. Sjellja ndërnjerëzore. Zgjidhni aktivitetet që mund të kryeni:		Po
Bashkëveproni me familjen	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Bashkëveproni me miqtë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Bashkëveproni me të huajt në rrugë, në treg etj.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Filloni dhe ruani një marrëdhënie romantike	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
8. Sjellja në familje. Zgjidhni aktivitetet që mund të kryeni:	Po	Jo
Bëni pazar	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Gatuani	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Bëni aktivitete shtëpiake (Pastroni shtëpinë, pastroni enët)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
9. Jeta shoqërore dhe puna. Zgjidhni aktivitetet që mund të	Po	Jo
Ndiqni mësimet në shkollë/universitet çdo ditë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Shkuarja në punë çdo ditë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Shkoni në klube, ngjarje për rekreacion	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Shkuarja në pushime verore /dimërore	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Merrni pjesë në aktivitete fetare	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

C. Ndryshimi psikosocial nga pandemia COVID -19

Pjesa e mëposhtme e sondazhit na shërben të kuptojmë përjetimet e juaja emocionale përgjatë pandemisë COVID – 19.

10. A jeni infektuar me virusin COVID – 19?
<input type="checkbox"/> Po
<input type="checkbox"/> Jo
<input type="checkbox"/> Nuk e di

11. A keni qenë në kontakt me një person të infektuar me COVID – 19?
<input type="checkbox"/> Po
<input type="checkbox"/> Jo
<input type="checkbox"/> Nuk e di
12. A keni qenë të izoluar për shkak të pandemisë COVID – 19?
<input type="checkbox"/> Po
<input type="checkbox"/> Jo
13. A jeni i/e vaksinuar kundër virusit COVID - 19?
<input type="checkbox"/> Po
<input type="checkbox"/> Jo
14. Si jeni ndjerë kur keni kuptuar që jeni infektuar me virusin COVID – 19? Ju
<input type="checkbox"/> I/E Frikësuar
<input type="checkbox"/> I/E shqetësuar
<input type="checkbox"/> I/E zemëruar
<input type="checkbox"/> Konfuz/e
<input type="checkbox"/> I/E vetmuar
<input type="checkbox"/> I/E dëshpëruar
<input type="checkbox"/> I/E frikësuar nga përhapja e virusit tek anëtarët e familjes
<input type="checkbox"/> I/E panikosur
15. Në rast të izolimit, a keni pasur ndryshime emocionale?
<input type="checkbox"/> Po
<input type="checkbox"/> Jo
Nëse po,ju lutem ndani ato me ne:
16. Mungesa e aktiviteteve sociale përgjatë pandemisë COVID – 19, a ka ndikuar
<input type="checkbox"/> Po
<input type="checkbox"/> Jo
Nëse po, trego si ka ndikuar kjo tek gjendja juaj emocionale
17. Informimi në media (TV, rrjete sociale, radio) rreth ngjarjeve dhe vendimeve

<input type="checkbox"/> Ka ndikuar shumë
<input type="checkbox"/> Ka ndikuar pak
<input type="checkbox"/> Mesatarisht
<input type="checkbox"/> Nuk ka ndikuar
<input type="checkbox"/> Aspak nuk ka ndikuar
18. Humbja e familjarëve si pasojë e COVID – 19 (nëse aplikohet) si ka ndikuar
19. A ka sjell frikë tek ju pasiguria ekonomike e shfaqur gjatë këtyre viteve?
<input type="checkbox"/> Po
<input type="checkbox"/> Jo
Nëse po, çfarë lloj frike:
20. Përgjatë pandemisë COVID-19, me çfarë sfidash jeni përballur në balancimin
<input type="checkbox"/> Kujdesi për fëmijët/personat me aftësi të kufizuara
<input type="checkbox"/> Kujdesi për personat që kishin COVID-19 ose sëmundje të tjera në familjen
<input type="checkbox"/> Kujdesi për personat e moshuar
<input type="checkbox"/> Rritja e punëve të shtëpisë
<input type="checkbox"/> Nuk kam mjaftueshëm pajisje elektronike në shtëpinë time për nevojat e të
<input type="checkbox"/> Shfrytëzimi i transportit të sigurt për të shkuar në/kthyer nga puna
<input type="checkbox"/> Dhuna psikologjike në shtëpi
<input type="checkbox"/> Dhuna fizike në shtëpi
<input type="checkbox"/> Stresi
<input type="checkbox"/> Tjetër (ju lutem specifikoni)
<input type="checkbox"/> Nuk kam pasur sfida

D. Diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar

Në këtë pjesë të sondazhit, po kërkojmë të gjejmë nëse keni përjetuar ndonjë diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar përgjatë pandemisë COVID-19 e tutje, dhe nëse po, si ka ndikuar tek ju.

21. A keni përjetuar ndonjëherë ngacmim direkt ose indirekt, ngacmim në rrugë
<input type="checkbox"/> Po
<input type="checkbox"/> Jo

Nuk e di

Nëse jo, ju lutem kaloni në pyetjen 23.

Nëse po, ju lutem përshkruani:

22. Ku kanë ndodhur këto incidente? Ju lutemi zgjidhni sa më shumë që

Në shtëpi

N shkollë

Në punë

Në dyqan/restaurant

Në rrugë

Në një tjetër ambient publik

23. Nëse do të ngacmoheshin në punë, shkollë apo kolegji ku do të shkonit për

Menaxheri/mbikëqyrësi

Kolegjet

Mësimdhënës/profesor

Nuk do ndihesha rehat për të kërkuar ndihmë dhe mbështetje në vend të punës

Nuk e di

24. A do të ndjeheshit rehat që të raportoni ngacmimet që ju ndodhin në shtëpi,

Po

Jo

Nuk e di

25. Nëse përgjigja juaj në pyetjen e mësipërme ishte Po apo Jo, ju lutem elaboroni

26. A ka shkolla/kolegji/vendi juaj i punës një politikë të publikuar për

Po

Jo

Nuk e di

E. Qasja në shërbime publike

Në këtë pjesë të sondazhit ne duam të shikojmë se cilat shërbime publike keni përdorur përgjatë pandemisë COVID - 19 dhe nëse mendoni se ju mungon ndonjë shërbim në të cilin dëshironi të keni qasje.

27. Nga cila skemë pensionale të aftësisë së kufizuar përfitoni nga Qeveria?		
<input type="checkbox"/>	Pension të fëmijëve me aftësi të kufizuar (100€)	
<input type="checkbox"/>	Pensioni për të rritur me aftësi të kufizuar (100€)	
<input type="checkbox"/>	Pensioni për tetraplegjik dhe paraplegjik (375€)	
<input type="checkbox"/>	Nuk përfitoj nga skemat pensionale për persona me aftësi të kufizuar	
28. A ju është ndalur pensioni për aftësinë e kufizuar nga Qeveria për shkak të		
<input type="checkbox"/>	Po	
<input type="checkbox"/>	Jo	
29. Në vitin e kaluar, a keni përdorur në ndonjë nga shërbimet e mëposhtme? Ju		
<input type="checkbox"/>	Shërbimet e banimit - strehim i mbështetur, banesa sociale, sektori publik, me	
<input type="checkbox"/>	Shëndetësi – Spital, QKMF, QMF, Qendra e shëndetit mendor	
<input type="checkbox"/>	Krimi dhe siguria - policia, shërbimet kundër dhunës në familje	
<input type="checkbox"/>	Shërbimet e punësimit dhe këshillimit - Kjo mund të përfshijë: Zyrën e	
<input type="checkbox"/>	Arsim – universitet, gjimnaz, shkolla, program trajnimi në sektorin publik.	
<input type="checkbox"/>	Shërbime transporti - çdo lloj transporti publik	
<input type="checkbox"/>	Mirëqenia Sociale: Kjo mund të përfshijë: Qendra për Punë Sociale (QPS),	
<input type="checkbox"/>	Shërbimet për kohë të lirë dhe rekreacion - këtu mund të përfshihen qendra e	
<input type="checkbox"/>	Të	
30. Në institucionet e mëposhtme, a ka qasje për persona me aftësi të kufizuar?		
	Po	Jo
Komuna e Mitrovicës Jugore	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Spital	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Qendra për Punë Sociale	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Qendra e Kulturës	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Polici	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Universiteti “Isa Boletini” i Mitrovicës	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Shkolla	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Posta	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>			
31. Në një shkallë nga 1-5, sa të kënaqur jeni me shërbimet e diskutuara në pyetjen					
	1	2	3	4	5
Shërbimet e banimit	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Shëndetësi	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Krimi dhe siguria	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Shërbimet e punësimit	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Arsim	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Shërbime transporti	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Mirëqenia Sociale	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Shërbime për kohë të	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Të tjera	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
32. Nëse keni ndonjë shembull apo përvojë specifike nga lista e shërbimeve					
33. Nëse keni pasur përvoja negative të qasjes në shërbimet publike, çfarë					
34. Sipas ju, cilat janë nevojat e personave me aftësi të kufizuar që duhet të					

F. Kualifikimet për punësim

35. Çfarë lloj shkolle keni përfunduar apo jeni duke e ndjekur?
<input type="checkbox"/> Shkollë e rregullt
<input type="checkbox"/> Shkollë e arsimit special

36. Cili është niveli juaj i edukimit?	
<input type="checkbox"/>	Pa arsim
<input type="checkbox"/>	Shkollë elementare
<input type="checkbox"/>	Diplomë e shkollës së mesme
<input type="checkbox"/>	Diplomë Aftësimi Profesional
<input type="checkbox"/>	Diplomë bachelor
37. Cila është gjuha juaj amtare?	
<input type="checkbox"/>	Shqip
<input type="checkbox"/>	Serbisht
<input type="checkbox"/>	Tjetër gjuhë (shto në vazhdim):
38. A flisni gjuhë të tjera përkrah gjuhës amtare?	
<input type="checkbox"/>	Po
<input type="checkbox"/>	Jo
Nëse "Po" ju lutem specifikoni:	
39. A keni ndjekur ndonjëherë ndonjë kurs trajnimi / punëtori për të fituar	
<input type="checkbox"/>	Po
<input type="checkbox"/>	Jo
I. Emri i kursit:	
Niveli i aftësive:	<input type="checkbox"/> Fillestar <input type="checkbox"/> I ndërmjetëm <input type="checkbox"/> Ekspert
II. Emri i kursit:	
Niveli i aftësive:	<input type="checkbox"/> Fillestar <input type="checkbox"/> I ndërmjetëm <input type="checkbox"/> Ekspert
III. Emri i kursit:	
Niveli i aftësive:	<input type="checkbox"/> Fillestar <input type="checkbox"/> I ndërmjetëm <input type="checkbox"/> Ekspert

G. Punësimi

40. A keni qenë i/e punësuar ndonjëherë?	
<input type="checkbox"/>	Po
<input type="checkbox"/>	Jo
Nëse "Po", ju lutemi shënoni emrin e kompanisë, pozicionin e mbajtur dhe	
Kompania/Organizata:	
Pozita:	
Kohëzgjatjen e shërbimit:	

41. A jeni intervistuar ndonjëherë për një vend pune?
<input type="checkbox"/> Po
<input type="checkbox"/> Jo
42. Sa kohë keni kërkuar punë?
<input type="checkbox"/> Më pak se një vit
<input type="checkbox"/> > 1 vit
<input type="checkbox"/> > 5 vite
<input type="checkbox"/> Unë kam kërkuar një punë gjatë gjithë jetës sime
43. A iu është përshtatur vendi i punës në të cilin keni aplikuar nevojave tuaja?
<input type="checkbox"/> Po
<input type="checkbox"/> Jo
<input type="checkbox"/> Pjesërisht
44. Çfarë lloj punësimi do të pranoni (nëse ju ofrohet)?
<input type="checkbox"/> Çdo lloj pune
<input type="checkbox"/> Unë nuk do të pranoja asnjë lloj pune
<input type="checkbox"/> Punësimi që i përshtatet kualifikimeve të mia
<input type="checkbox"/> Punësimi që i përshtatet aftësive dhe nevojave të mia
45. A mendoni se mundësitë për punësim të personave me aftësi të kufizuara janë
<input type="checkbox"/> Mundësitë e punësimit janë të njëjta si më parë
<input type="checkbox"/> Më e favorshme se më parë
<input type="checkbox"/> Më pak e favorshme se më parë
46. Si ndiheni për perspektivat e punësimit tuaj?
<input type="checkbox"/> Shumë i/e pasigurt (në lidhje me punësimin)
<input type="checkbox"/> I/e pasigurt
<input type="checkbox"/> I/e sigurt
<input type="checkbox"/> Shumë i/e sigurt
47. Cilat ishin pengesat më të mëdha me të cilat jeni përballur kur keni kërkuar
<input type="checkbox"/> Paragjykimet që të tjerët kanë rreth personave me aftësi të kufizuara
<input type="checkbox"/> Mungesa e eksperiencës
<input type="checkbox"/> Mungesa e motivimit
<input type="checkbox"/> Mjedisi jo i arritshëm i punës
<input type="checkbox"/> Transporti

Edukim joadekuat

Vështirësitë në krijimin e komunikimit me të tjerët

48. A jeni përballur me diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar kur keni

Po

Jo

Nëse po, ju lutem elaboroni:

49. Cilat janë fushat tuaja të interesit profesional?

Teknologjia e informacionit (kompjuterë, kodues, elektronikë)

Kontabiliteti (llogaritari, zyrtari i kredisë bankare)

Këshillim për persona të tjerë me aftësi të kufizuara (shërbime sociale,

Ligji (avokat, avokat i të drejtave të njeriut)

Art (muzikë, pikturë)

Shtëpiake (shërbime gatimi, pastrimi)

Gazetari (gazetar, reporter)

Prodhim artizanal (bërja e bizhuterive, riparime të vogla në shtëpi)

Shërbime shëndetësore mjekësore (masazh)

Tjetër (Ju lutem specifikoni):

50. A do të angazhoheshit të ndiqni një kurs të gjatë 3-6 muaj?

Po

Jo

Nuk jam i/e sigurt

51. Në cilat kurse dëshironi të merrni pjesë?

Kurse për IT

Shitje dhe Marketing për biznese të vogla

Bazat e kontabilitetit, taksat dhe kontabiliteti

Praktikat më të mira bujqësore

Analiza e ndikimit në mjedis (cilësia e tokës, cilësia e ajrit, cilësia e ujit)

Menaxhimi i biznesit të vogël, aftësitë organizative dhe drejtuese

Tjetër, ju lutem specifikoni:

52. Arsimi profesional:

Hidraulik

<input type="checkbox"/> Stilim i flokëve, Kozmetikë dhe Grim
<input type="checkbox"/> Rrobaqepësi
<input type="checkbox"/> Elektracist
<input type="checkbox"/> Karpentieri
<input type="checkbox"/> Mekanik
<input type="checkbox"/> Artet e kuzhinës
<input type="checkbox"/> Tjetër (ju lutem specifikoni)
53. A keni humbur punën përgjatë pandemisë COVID-19?
<input type="checkbox"/> Po
<input type="checkbox"/> Jo
<input type="checkbox"/> Nuk kam qenë duke punuar
54. A keni shprehur interes për të aplikuar në thirrjen e qeverisë në kuadër të masës
<input type="checkbox"/> Po
<input type="checkbox"/> Jo
Nëse "Po", ju lutemi shënoni emrin e organizatës, pozicionin për të cilin keni
Kompania/Organizata:
Pozita:
Kohëzgjatjen e shërbimit:
55. Si jeni informuar mbi mundësinë e aplikimit të thirrjes së qeverisë për masën
<input type="checkbox"/> Përmes mediave (TV, rrjete sociale, radio)
<input type="checkbox"/> Përmes organizatave (Handikos, të tjera)
<input type="checkbox"/> Nga familja dhe/apo shoqëria
<input type="checkbox"/> Përmes telefonave direkte nga qeveria

H. Përfaqësimi Politik

Në këtë pjesë të sondazhit ne duam të zbulojmë se sa i/e përfshirë politikisht jeni, sa i/e përfshirë politikisht dëshironi të jeni dhe nëse jeni në gjendje t'i komunikoni çdo çështje që keni si person me aftësi të kufizuara tek zyrtarët tuaj lokal (asambleistët komunal, drejtoritë) ose kryetarin e komunës.

56. A ndiheni të përfshirë në vendimmarrjen lokale në qytetin tuaj?
<input type="checkbox"/> Po

<input type="checkbox"/> Jo
<input type="checkbox"/> Pjesërisht
<input type="checkbox"/> Nuk e di
57. A keni pasur rast të diskutoni ndonjëherë me zyrtarët lokal/asambleistët
<input type="checkbox"/> Po
<input type="checkbox"/> Jo
58. A do të ndiheshit rehat të flisni me zyrtarët lokal/asambleistët komunal për
<input type="checkbox"/> Po
<input type="checkbox"/> Jo
59. A keni pasur rast të diskutoni ndonjëherë me zyrtarët lokal/asambleistët
<input type="checkbox"/> Po
<input type="checkbox"/> Jo
60. Sa të përfaqësuar ndiheni nga politikanët lokal?
<input type="checkbox"/> Shumë mirë i/e përfaqësuar
<input type="checkbox"/> Mirë i/e përfaqësuar
<input type="checkbox"/> I/e përfaqësuar
<input type="checkbox"/> I/E pa përfaqësuar
<input type="checkbox"/> I/E pa përfaqësuar fare
61. A do të konsideroni të kandidoni për qeverisjen lokale (p.sh. Anëtar i
<input type="checkbox"/> Po
<input type="checkbox"/> Jo
Nëse "Po", ju lutemi shënoni se për çfarë pozite do të kishit kandiduar.
Pozita:
62. Çka, nëse ndonjë gjë ju pengon ta merrni parasysh këtë?

Gusht, 2022